18	Haki Molishti	8505	754	Ullishtë	4,200	216,31	1,800	389,358			-	10,000	399,358	Haki Molishti (ndalohen veprimet në këtë pasuri deri në zgjidhjen e problemit të AMT-së).
19	Bujar Molishti	8505	753	Ullishtë	4,000	73,61	1,800	132,498			-	-	132,498	Bujar Molishti (Seksioni E-ndalohen veprimet në këtë pasuri deri në zgjidhjen e problemit të AMT-së).
20	Gjergji Kallidremshi & Aleksander Kallidremshi	8505	747	Ullishtë	6,300	126,80	1,800	228,240			-	20,000	248,240	
21	Shpejtim Xhevit Qose	8505	746	Ullishtë	2,000	73,59	1,800	132,462			-	-	132,462	
22	Arben Tahiriq	8505	735/3	Ullishtë	7,550	3,32	1,800	5,976			-	-	5,976	
23	Naim Caco	8505	772/1	Ullishtë	1,930	462,00	1,800	831,600			-	-	831,600	
24	Vlasi Pambuku	8505	737/6	Ullishtë	514	9,00	1,800	16,200			-	56,000	72,200	
25	Gjergji Kallidremshi	8505	737/4	Ullishtë	1,224	103,00	1,800	185,400			-	40,000	225,400	
26	Sako Molishti	8505	749	Ullishtë	2,000	240,69	1,800	433,242			-	-	433,242	Sako Molishti (Seksioni E-ndalohen veprimet në këtë pasuri deri në zgjidhjen e problemit të AMT-së).
27	Demir Ali Nallbani	8505	733/3	Ullishtë	2,127	33,68	1,800	60,624			-	-	60,624	
28	Hajrije Ali Agalliu	8505	733/4	Ullishtë	1,147	18,58	1,800	33,444			-	-	33,444	
29	Vangjel Papaiongi & Spiro Papaiongi	8505	738	Ullishtë	4,000	321,18	1,800	578,124			-	88,000	666,124	
30	Stavi Luci Duhurshi & Aferdita Luci Natio	8505	735/2	Ullishtë	3,000	145,41	1,800	261,738			-	50,000	311,738	
31	Algerta Vladimire Frasheri	8505	733/1	Ullishtë	4,000	176,24	1,800	317,232			-	-	317,232	
Shuma					85,832	6,943		12,497,778	10,26		42,918	676,000	13,216,696	

Shënim.

1. Vlerësimi i pasurive është kryer bazuar në pikën 4, të nenit 17, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private , për interes publik", të ndryshuar.



VENDIM

Nr. 46, datë 27.1.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 436, DATË 3.6.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE, PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITET AKADEMIKE 2020–2021 DHE 2021–2022 E NË VIJIM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 436, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) në pikën 1, pas fjalëve “për vitin akademik 2020–2021” shtohen fjalët “dhe në vijim”;

b) pika 2 shfuqizohet;

c) në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur vendimit, titulli riformulohet, si më poshtë vijon:

“(Programet e studimit të gjuhëve të huaja, për vitin akademik 2020–2021 dhe në vijim)”;

ç) shtojca nr. 2, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

1.

2. SHTOJCA NR. 2

3. (PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR”, TË CILAT JAPIN AKSES NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË “MASTER”, NË FUSHËN E MËSUESISË, PËR VITIN AKADEMIK 2020–2021 DHE NË VIJIM)

Nr.	INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE, VITI AKADEMIK 2020–2021 DHE NË VIJIM
1	Universiteti i Tiranës	Biologji	7.5
2		Filozofi	7.5
3		Fizikë	7.5
4		Gjeografi	7.5
5		Gjuhë-letërsi	7.5
6		Histori	7.5
7		Informatikë	7.5
8		Kimi	7.5
9		Matematikë	7.5
10		Psikologji	7.5
11		Sociologji	7.5



Nr.		PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”	Biologji-kimi	7.5
2		Edukim qytetar	7.5
3		Filozofi-sociologji	7.5
4		Gjeografi dhe gjuhë italiane	7.5
5		Gjuhë shqipe dhe letërsi	7.5
6		Histori-gjeografi	7.5
7		Histori dhe gjuhë gjermane	7.5
8		Matematikë informatike	7.5
9		Matematikë-fizikë	7.5
10		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
11		Mësuesi për arsim fillor	7.5
12		Psikologji	7.5
13		Gjuhë shqipe dhe frënge	7.5
14		Gjuhë shqipe dhe rome	7.5
Nr.		PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës	Gjuhë-letërsi-anglisht	7.5
2		Histori	7.5
3		Informatikë-anglisht	7.5
4		Matematikë-informatikë	7.5
5		Mësuesi për arsim fillor	7.5
6		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
7		Psikologji	7.5
8		Filozofi-sociologji	7.5
Nr.		PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë	Biologji-kimi	7.5
2		Gjuhë-letërsi shqipe	7.5
3		Gjuhë-letërsi angleze	7.5
4		Gjuhë-letërsi dhe qytetërim grek	7.5
5		Gjuhë-letërsi italiane	7.5
6		Histori-gjeografi	7.5
7		Matematikë-informatikë	7.5
8		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
9		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
10		Fizikë dhe teknologji informacioni	7.5
11		Matematikë-fizikë	7.5
Nr.		PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë	Biologji-kimi	7.5
2		Filozofi-sociologji	7.5
3		Gjuhë-letërsi	7.5
4		Histori-gjeografi	7.5



5		Matematikë-fizikë	7.5
6		Matematikë-informatikë	7.5
7		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
8		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
Nr.		PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë	Biologji	7.5
2		Fizikë	7.5
3		Gjuhë shqipe dhe letërsi	7.5
4		Histori-gjeografi	7.5
5		Informatikë	7.5
6		Kimi	7.5
7		Matematikë	7.5
8		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
9		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
10		Pedagogji e specializuar	7.5
Nr.		PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1	Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	Biologji-kimi	7.5
2		Fizikë	7.5
3		Gjeografi	7.5
4		Gjuhë-letërsi	7.5
5		Histori	7.5
6		Informatikë	7.5
7		Matematikë	7.5
8		Mësuesi për arsim fillor	7.5
9		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
10		Psikologji	7.5
Nr.		PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1	Kolegji Universitar “Bedër”	Arsimi parashkollor dhe fillor	7.5
2		Psikologji këshillimi dhe pedagogji	7.5
Nr.	Kolegji Universitar “Wisdom”	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Psikologji	7.5
Nr.	Universiteti “Barleti”	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Psikologji	7.5
Nr.		PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1	Universiteti Europian i Tiranës	Psikologji	7.5
2		Sociologji	7.5
3		Filozofi	7.5
4		Histori	7.5
5		Letërsi	7.5
6		Linguistikë	7.5
7		Arsim parashkollor	7.5
Nr.	Universiteti i New York-ut në Tiranë	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Psikologji	7.5
Nr.		PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1	Universiteti “Albanian University”	Mësuesi për arsimin fillor	7.5
2		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
3		Psikologji e përgjithshme	7.5
Nr.	Kolegji Universitar “Logos”	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5



VENDIM
Nr. 47, datë 27.1.2021

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
DREJTËSISË TE MINISTRIA E
TURIZMIT DHE MJEDISIT, TË NJË
PJESË TË PRONËS SË PALUAJTSHME
ME SIPËRFAQE PREJ 19 000 M², NGA
TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS
NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE
8340, ME NUMËR PASURIE 8/76, ME
SIPËRFAQE PREJ 46 266 M², ME
EMËRTIMIN “STACION
HEKURUDHOR”, TIRANË, SI DHE PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.
714, DATË 20.10.2011, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KALIMIN E
PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT,
NGA MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT TE MINISTRIA E
DREJTËSISË, TË SIPËRFAQES 46 266 M²,
NË ZONËN KADASTRALE NR. 8340, ME
NUMËR PASURIE 8/76, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 120,
DATË 4.3.2004, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, ‘PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të
neneve 13 dhe 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743,
datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të
shetit”, të ndryshuar, si dhe të pikës 1, të nenit

34, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të
ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit
dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga
Ministria e Drejtësisë te Ministria e Turizmit dhe
Mjedisit, të një pjese të pronës së paluajtshme me
sipërfaqe prej 19 000 (nëntëmbëdhjetë mijë) m²,
nga trualli funksional i pronës në zonën
kadastrale 8340, me numër pasurie 8/76, me
emërtim “Stacion hekurudhor”, Tiranë, me
sipërfaqe 46 266 (dyzet e gjashtë mijë e dyqind e
gjashtëdhjetë e gjashtë) m², sipas planvendosjes
bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim përdorimin
e saj për zhvillimin e qëndrueshëm në turizëm.

2. Sipërfaqja prej 19 000 (nëntëmbëdhjetë
mijë) m² e truallit, e përmendur në pikën 1, të
këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të
pronave të paluajtshme shetëtorore, që i
bashkëlidhet vendimit nr. 714, datë 20.10.2011,
të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe
Mjedisit, Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia
Shetëtorore e Kadastrës për zbatimin e këtij
vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në
Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



**VENDIM****Nr. 48, datë 27.1.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT DHE
RIKONSTRUKSIONIT/RIFORCIMIT TË
OBJEKTEVE NË ADMINISTRIM TË
SHËRBIMIT INFORMATIV TË
SHTETIT, NË BASHKITË DURRËS DHE
LEZHË, DHE CAKTIMIN E SHËRBIMIT
INFORMATIV TË SHTETIT
SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nëndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit/riforcimit të objekteve në administrim të Shërbimit Informativ të Shtetit, të ndodhura në bashkitë Durrës dhe Lezhë, në masën 21 586 378 (njëzet e një milionë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) rindërtimi i objektit në administrim të Shërbimit Informativ të Shtetit (SHISH), të ndodhur në Bashkinë Durrës, në masën 17 402 445 (shtatëmbëdhjetë milionë e katërqind e dy mijë e katërqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH;

b) rikonstruksioni/riforcimi i objektit në administrim të Shërbimit Informativ të Shtetit (SHISH), të ndodhur në Bashkinë Lezhë, në masën 4 183 933 (katër milionë e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë nëntëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

2. Shërbimit Informativ të Shtetit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i shtohet fondi në masën 7 220 733 (shtatë milionë e dyqind e njëzet mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit/riforcimit të objekteve, sipas pikës 1 të këtij vendimi, i detajuar si më poshtë vijon:

a) në masën 5 220 733 (pesë milionë e dyqind e njëzet mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të objektit në administrim, të ndodhur në Bashkinë Durrës;

b) në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit/riforcimit të objektit, të ndodhur në Bashkinë Lezhë.

3. Caktimin e Shërbimit Informativ të Shtetit si njësi zbatuese për rindërtimin dhe rikonstruksionin/riforcimin e objekteve, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 49, datë 27.1.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
HARTIMIT TË PROJEKTIT TË
NDËRHYRJEVE
REHABILITUESE/PËRSHTATËSE, TË
NEVOJSHME PËR KTHIMIN E
STRUKTURËS SË OBJEKTEVE, QË JANË
KLASIFIKUAR SI OBJEKTE ME
DËMTIME TË MËDHA STRUKTURE
OSE DËMTIME SHUMË TË RËNDA
JOSTRUKTURE, NË BASHKINË
KAVAJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nëndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për



menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 73 699 921 (shtatëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve, që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore, në Bashkinë Kavajë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2021, dhe i transferohet në formën e transfertës së pakushtëzuar Bashkisë Kavajë.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 50, datë 27.1.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTEA (PALLAT), NË BASHKITË RROGOZHINË, MIRDITË DHE KAMZË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me

propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 180 890 000 (njëqind e tetëdhjetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ato individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në bashkitë Rrogozhinë, Mirditë dhe Kamzë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Rrogozhinë i transferohet fondi në masën 61 270 000 (gjashtëdhjetë e një milionë e dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë;

b) Bashkisë Mirditë i transferohet fondi në masën 11 150 000 (njëmbëdhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë;

c) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi në masën 108 470 000 (njëqind e tetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë mijë) lekë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga pjesa e financuar nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe t’u kalojë bashkive Rrogozhinë, Mirditë dhe Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Rrogozhinë, Mirditë dhe Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

**UDHËZIM****Nr. 4, datë 22.1.2021****PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
TË DHËNIES SË LEJEVE
SHPËRBLYESE APO TË VEÇANTA PËR
TË DËNUARIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 72, pika 7, të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”,

UDHËZOJ:**I. OBJEKTI**

Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave për dhënien e lejeve shpërblyese për të dënuarit, si dhe miratimin e formateve standarde të kërkesave për leje shpërblyese apo të veçanta, si dhe miratimin e formateve të regjistrave të lejeve për të dënuarit.

II. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Drejtori i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (në vijim “IEVP”) është autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës dhe dhënien e lejeve shpërblyese në burgjet e sigurisë së ulët dhe të sigurisë së zakonshme, si dhe për dhënien e lejeve të veçanta personave të dënuar.

2. Drejtoritë e IEVP-ve, në çdo fillim viti, hartojnë planifikimin vjetor paraprak të të dënuarve, që plotësojnë afatin kohor ligjor për trajtim me leje shpërblyese, të ndarë sipas muajve kalendarikë dhe të shoqëruar me dokumentacionin përkatës, të cilin ia dërgojnë zyrtarisht drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

3. Në listën e planifikimit vjetor shtohen edhe të dënuarit, që gjatë vitit hyjnë në afatet ligjore për trajtim me leje shpërblyese.

4. Edukatori i grupit njofton paraprakisht çdo të dënuar për planifikimin e tij.

5. Kërkesa e paraqitur nga personi i dënuar për leje shpërblyese apo të veçantë, drejtuar drejtorit të IEVP-së, është sipas formatit në shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi. IEVP-ja merr masa për t’u siguruar të

burgosurve kopje të kërkesës për leje shpërblyese apo të veçantë.

6. Regjistrimi i kërkesave të personave të dënuar për leje shpërblyese apo të veçantë bëhet në një regjister të veçantë, të krijuar për këtë qëllim, i cili titullohet “Regjistri i lejeve shpërblyese dhe të veçanta të IEVP-së” (duke cilësuar emrin e institucionit). Format i këtij regjistri përcaktohet në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

**III. PROCEDURA PËR LEJEN
SHPËRBLYESE**

1. Dokumentacioni për dhënien e një lejeje shpërblyese është si më poshtë:

a) kërkesë e të dënuarit, sipas formatit në shtojcën nr. 2;

b) urdhër i drejtorit për fillimin e procedurave të shqyrtimit, sipas formatit në shtojcën nr. 7;

c) kthim përgjigjeje për të dënuarin në rast refuzimi, sipas formatit në shtojcën nr. 8;

ç) raport i sektorit ligjor, sipas formatit në shtojcën nr. 3;

d) raport i sektorit të kujdesit social dhe të sigurisë, sipas formatit në shtojcën nr. 4;

dh) dinamikë e vuajtjes së dënimit;

e) urdhër për miratimin e lejes, sipas formatit në shtojcën nr. 9;

ë) dokumentacion për “Leje shpërblyese”, që merr i dënuari me vete, sipas formatit në shtojcën nr. 10;

f) njoftim për komisariatit, sipas formatit në shtojcën nr. 11;

g) përgjigje të komisariatit të vendbanimit të të dënuarit.

2. Me marrjen e kërkesës për leje shpërblyese nga i dënuari, drejtori i IEVP-së, brenda 3 (tri) ditëve nxjerr një urdhër me shkrim për fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për leje shpërblyese nga sektorët përgjegjës në IEVP.

3. Të dënuarit e planifikuar për leje shpërblyese, para daljes me leje, i nënshtrohen një procesi vlerësimi për sjelljen dhe qëndrimin e tij, respektimin e rregullave të disiplinës dhe rregullores së brendshme të institucionit, motivimin dhe pjesëmarrjen në programet rehabilituese e të riintegritit dhe rrezikshmërinë shoqërore.

4. Të dënuarit kanë të drejtë të marrin leje shpërblyese, por jo më shumë se 20 ditë në vit. Kohëzgjatja në ditë e lejes për çdo të dënuar



përcaktohet duke marrë në konsideratë dhe duke vlerësuar disa tregues, si: sjellja e të dënuarit, trajtimi për herë të parë me leje shpërblyese, pjesa e mbetur e dënimit, situata social-ekonomike e familjes.

5. Sektori ligjor i IVEP-së, gjatë shqyrtimit të kërkesës për leje shpërblyese, përgatit raportin sipas formatit të shtojcës nr. 3, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

6. Sektori i sigurisë dhe i kujdesit social, gjatë shqyrtimit të kërkesës për leje shpërblyese, përgatit raportin e përbashkët sipas formatit në shtojcës nr. 4, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

7. Drejtori i IIEVP-së shqyrton kërkesën dhe raportet e sektorit ligjor, kujdesit social dhe të sigurisë. Në rast refuzimi, brenda 48 orëve i kthen përgjigje të arsyetuar me shkrim të burgosurit, sipas formatit në shtojcën nr. 8, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

8. Drejtori i IIEVP-së, 24 orë para ditës së planifikuar për leje ose ditën e planifikimit të lejes, nxjerr urdhrin për miratimin e lejes shpërblyese, sipas formatit në shtojcës nr. 9, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Me këtë urdhrë njihet edhe i dënuari, i cili firmos në kopjen që mbahet në arkivin e IIEVP-së.

9. I dënuari, në ditën që do të shkojë me leje shpërblyese, pajiset me dy kopje të dokumentacionit “Leje shpërblyese”, sipas formatit në shtojcën nr. 10, bashkëlidhur këtij udhëzimi, një kopje të të cilit e dorëzon në komisariatit e vendbanimit.

10. IIEVP-ja përkatëse dërgon njoftim përmes *email*-it zyrtar dhe komunikon përmes telefonit me komisariatit ku ka vendbanimin i dënuari, që ka përfituar leje shpërblyese, duke e informuar atë, sipas formatit në shtojcën nr. 11, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

11. Për të gjithë të dënuarit, që do të trajtohen për herë të parë me leje shpërblyese, kërkohet paraprakisht informacion zyrtar në komisariatit e vendbanimit të të dënuarit, lidhur me sigurinë e të dënuarit, familjes dhe/apo komunitetit, gjatë trajtimit me leje shpërblyese.

12. Për të dënuarit, që shkojnë me leje shpërblyese, për të cilët ka informacione në rrugë operative se mund të kenë edhe dënime ose probleme në shtete të tjera, vendime gjyqësore të tjera, brenda ose jashtë shtetit, kërkohet

paraprakisht informacion për ta në prokuroritë dhe komisariatet e vendbanimit të të dënuarve.

13. Punonjësit e kujdesit social, përpara hartimit të raporteve për lejet shpërblyese, duhet të marrin në konsideratë masat disiplinore të dhëna (sipas afateve të parashikuara në nenin 67, pika 6, e ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”), takimet me të afërmit, nivelin e riskut, sjelljen me të burgosurit e punonjësit në institucion, natyrën dhe llojin e veprës së kryer.

14. Punonjësit e sektorit ligjor dhe ata të kujdesit social vlerësojnë vendimet e gjykatës që ndodhen në dosje dhe vërtetimin e gjendjes gjyqësore të të dënuarve. Është e nevojshme që të gjitha dosjet personale të të dënuarve të plotësohen me vërtetimin e gjendjes gjyqësore për të gjitha dënimet e mëparshme që mund të kenë pasur të dënuarit.

15. Vlerësimi i sjelljes së të burgosurve për leje shpërblyese bëhet nga komisioni i vlerësimit të sjelljes në IIEVP dhe administrohet në dosjen personale të të dënuarit.

16. Sjellja e të burgosurit vlerësohet e mirë, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

a) kur i dënuari nuk ka paraqitur rrezikshmëri të veçantë shoqërore, brenda një viti nga paraqitja e kërkesës;

b) kur gjatë vuajtjes së dënimit dhe në mënyrë të vazhdueshme i dënuari ka shfaqur ndjenjë përgjegjësie dhe korrektesë në sjelljen e tij personale në marrëdhëniet me personelin e IIEVP-së, si dhe në aktivitetet e organizuara nga institucioni;

c) kur i dënuari krijon besimin e një qëndrimi të mirë jashtë institucionit;

ç) kur i dënuari tregon qëndrim korrekt dhe joagresiv ndaj personelit të IIEVP-së, si dhe ndaj vizitorëve që hyjnë në institucion dhe nuk ka kryer kundër tyre veprime, që sipas Kodit Penal konsiderohen vepra penale;

d) kur i dënuari ka respektuar afatet në rikthimin e tij në institucion, pas lejeve të mëparshme të dhëna;

dh) kur i dënuari i bindet urdhrave të dhëna nga personeli i IIEVP-së;

e) kur i dënuari nuk ka nxitur apo nuk është përfshirë në rebelimin (revoltën) e të burgosurve brenda IIEVP-së;



e) kur i dënuari nuk ka përdorur dhunë ndaj të burgosurve të tjerë apo punonjësve të institucionit, me qëllim pengimin e ushtrimit të detyrës apo të shërbimit;

f) kur i dënuari nuk ka tentuar më parë të largohet pa leje apo nuk është larguar nga vendi i qëndrimit të tij të detyrueshëm;

g) kur i dënuari nuk ka treguar neglizhencë në kryerjen e detyrave të caktuara nga personeli i IEVP-së;

gj) kur i dënuari me sjelljen e tij nuk simulon në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore;

h) kur i dënuari nuk ka kryer akte apo vepra të tjera, të cilat cenojnë dukshëm qetësinë dhe moralin në IEVP;

i) kur i dënuari nuk ka mbajtur ose shpërndarë sende që mund të përdoren për të dëmtuar jetën, shëndetin, e personave të tjerë, sigurinë në institucion apo sende personale, që janë të ndaluara për t'u mbajtur, sipas parashikimeve në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve;

j) kur i dënuari ka treguar administrim dhe kujdes të mirë për sendet apo pajisjet e institucionit, duke mos i dëmtuar apo i përvetësuar ato;

k) kur i dënuari nuk ka treguar neglizhencë në higjienën dhe mbajtjen e pastër dhe të rregullt të tij, si dhe në mbajtjen pastër dhe në mënyrë të rregullt të dhomës dhe ambienteve të përbashkëta;

l) kur i dënuari nuk ka kryer aktivitete të tjera që janë të ndaluara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, si dhe në rregulloren e IEVP-së;

ll) kur i dënuari nuk ka kryer veprime ose mosveprime, që kanë cenuar liritë dhe të drejtat themelore të të burgosurve të tjerë.

IV. PROCEDURA PËR LEJEN E VEÇANTË

1. Leja e veçantë jepet për shkak të sëmundjes së rëndë, që rrezikon jetën e prindërve, bashkëshortit/bashkëshortes, bashkëjetuesit/bashkëjetuses, fëmijëve, motrës, vëllait të të burgosurit.

2. Për qëllim të këtij udhëzimi, me sëmundje të rëndë do të kuptohet çdo sëmundje apo patologji organore, që vënë në rrezik në mënyrë serioze shëndetin apo jetën e pacientit anëtar i familjes së të burgosurit (nëna, babai, fëmijët, motra, vëllai, bashkëshorti/ja dhe bashkëjetuesi/ja), në atë masë

që mund të sjellin si pasojë vdekjen e tij dhe që, për këtë shkak, kërkon kujdes të veçantë mjekësor.

3. Për lejet e veçanta që jepen në rastet e sëmundjeve të rënda, që rrezikojnë jetën e një anëtar i të familjes (nëna, babai, fëmijët, motra, vëllai, bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesi/bashkëjetuesja), i burgosuri duhet të paraqesë te drejtori i IEVP-së dokumentet e mëposhtme provuese:

a) kërkesën për leje të veçantë, të plotësuar sipas formatit në shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi;

b) dokumentacionin nga gjendja civile, që provon lidhjen familjare të të burgosurit me të sëmurin, i cili duhet të jetë lëshuar nga organet kompetente, jo më parë se 10 (dhjetë) ditë;

c) vërtetimin e njësisë vendore të pushtetit lokal të lëshuara jo më parë se 10 (dhjetë) ditë nga momenti i dorëzimit të dokumenteve për leje pranë IEVP-së;

ç) dokumentin që provon sëmundjen e rëndë që rrezikon jetën, të lëshuar nga spitali publik apo privat ku është trajtuar familjari i sëmurë, me datën e lëshimit të epikrizës, datën e shtrimit (trajtimit) në spital, numrin e kartelës, pavionin ku është shtruar, lëshuar me firmën e tre mjekëve, vulat personale të tyre, si dhe vulën e institucionit që e lëshon të konfirmuar nga drejtori i institucionit mjekësor, numrat e telefonit të tre mjekëve dhe spitalit, për të konfirmuar vërtetësinë e dokumentacionit. Epikriza mjekësore, që lëshohet për sëmundjet e familjarëve të të burgosurve duhet të jetë me 3 (tri) firma origjinale (jo fotokopje) dhe duhet të paraqitet brenda 10 ditëve nga data e lëshimit të saj;

d) kopje të dokumentit të identifikimit të të familjarit të sëmurë.

4. Dokumentacioni, që përdoret për fillimin e procedurave për lejet e veçanta, dorëzohet në sekretarinë e institucionit nga familjari, i cili plotëson një formular vetëdeklarimi, sipas formatit në shtojcën nr. 14, me përgjegjësi për vërtetësinë dhe autenticitetin e materialit që dorëzon. Në këtë formular pasqyrohet vendbanimi i saktë i dorëzuesit, numrat e dokumentit identifikues (kartë identiteti ose pasaportë biometrike), numri i celularit dhe çdo e dhënë tjetër që identifikojnë me saktësi gjeneralitetet e dorëzuesit.



5. Kur shkaku i lejes së veçantë është sëmundja e rëndë e anëtarit të familjes së personit të burgosur, dokumenti mjekësor që shoqëron kërkesën për leje të veçantë vlerësohet edhe nga përgjegjësi i sektorit të shëndetësisë në IEVP ose, në mungesë të tij, nga mjeku i IEVP-së, i cili vlerëson epikrizën mjekësore, duke kontrolluar të gjitha elementet që provojnë vërtetësinë e saj. Pas kësaj, ai shprehet me shkrim për shkallën e rrezikshmërisë së sëmundjes së anëtarit të familjes së të burgosurit, kontrollon përmes komunikimit me telefon me mjekët që kanë nënshkruar epikrizën mjekësore të spitalit përkatës. Raporti i mjekut dhe mendimi i tij me shkrim hartohet sipas formatit në shtojcën nr. 6, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

6. Mendimi me shkrim nga përgjegjësi i sektorit të shëndetësisë ose, në mungesë të tij, nga mjeku i IEVP-së për sëmundjen e anëtarit të familjes së të burgosurit që kërkon leje të veçantë, duhet të jetë në përputhje me formatin në shtojcën nr.6, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

7. Mendimi me shkrim i mjekut, me propozimin për dhënien ose jo të lejes së veçantë, duhet të merret parasysh përpara përgatitjes së raportit të përbashkët nga ana e sektorit ligjor, sigurisë dhe kujdesit social në IEVP.

8. Leja e veçantë jepet, për shkak të vdekjes së fëmijëve, nënës, babait, bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es, motrave apo vëllezërve.

9. Për lejet e veçanta, që jepen në rastet e vdekjes së anëtarit të familjes (prindër, bashkëshort/bashkëshorte, bashkëjetues/e, fëmijë, motër, vëlla), i burgosuri duhet të paraqesë te drejtori i institucionit dokumentet e mëposhtme provuese:

a) kërkesën për leje të veçantë të plotësuar, sipas modelit tip të shtojcës nr. 2 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi;

b) dokumentacionin nga gjendja civile, që provon lidhjen familjare të të burgosurit me anëtarin e familjes që ka vdekur.

c) skedën origjinale të vdekjes të anëtarit të familjes së të burgosurit, lëshuar nga autoriteti përgjegjës shtetëror apo vërtetimin nga mjeku i zonës përkatëse, ku ka ndodhur vdekja (mjek, qendër shëndetësore, spital, urgjencë), në përputhje me ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar. Për vdekjet e

shkaktuara nga përdorimi i dhunës ose për vdekjet e dyshimta, si dhe për vdekjet në vendet e vuajtjes së dënimeve me burgim, vërtetimi është i vlefshëm vetëm kur lëshohet nga eksperti mjekoligjor dhe është i nënshkruar nga prokurori.

10. Leja e veçantë jepet, për shkak të lindjes së fëmijëve, motrave apo vëllezërve të të burgosurit.

11. Për lejet e veçanta që jepen në rastet e lindjes së anëtarit të familjes, i burgosuri duhet të paraqesë te drejtori i institucionit dokumentet e mëposhtme provuese:

a) kërkesën për leje të veçantë të plotësuar, sipas modelit tip të shtojcës nr. 2 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi;

b) dokumentacionin nga gjendja civile, që provon lidhjen familjare të të burgosurit me anëtarin e familjes të lindur;

c) certifikatën e lindjes së anëtarit të familjes së të burgosurit apo vërtetimin nga çdo subjekt shëndetësor, shtetëror apo privat, me të cilin, sipas ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, kanë të drejtë të njoftojnë lindjen dhe njoftimin për lindjet e ndodhura pranë institucionit të tyre;

ç) certifikatat duhet të jenë të lëshuara jo më vonë se 45 ditë nga dorëzimi i kërkesës për leje të veçantë.

12. Leja e veçantë jepet për shkak të martesës së vetë të burgosurit, prindërve, fëmijëve, motrave apo vëllezërve të të burgosurve.

13. Për lejet e veçanta që jepen në rastin e martesës së anëtarit të familjes ose vetë të burgosurit, ky i fundit duhet të paraqesë te drejtori i institucionit dokumentet e mëposhtme provuese:

a) kërkesën për leje të veçantë të plotësuar, sipas modelit tip të shtojcës nr. 2 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi;

b) certifikatën e martesës së anëtarit të familjes të të burgosurit, kërkesën për shpallje martese të lëshuar nga bashkia apo komuna, ku secili nga bashkëshortët e ardhshëm ka vendbanimin ose vendqëndrimin;

c) vërtetimin e njësisë vendore që vërteton datën e zhvillimit të ceremonisë së martesës nga të dy bashkëshortët;

ç) certifikatat duhet të jenë të lëshuara jo më vonë se 45 ditë nga dorëzimi i kërkesës për leje të veçantë.



14. Drejtori i IEVP-së:

a) Me marrjen e kërkesës nga i burgosuri për leje të veçantë, brenda 24 orësh nxjerr një urdhër me shkrim për fillimin e proceduarve për dhënien e lejes së veçantë nga sektorët përgjegjës, sipas formatit në shtojcën nr. 7/1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

b) Pasi shqyrton kërkesën dhe raportin e përbashkët të sektorit ligjor, kujdesit social dhe të sigurisë, brenda ditës i kthen përgjigje me shkrim të burgosurit lidhur me miratimin ose refuzimin e motivuar, sipas formatit në shtojcën nr. 8/2 dhe nr. 8/3 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

c) Në rastin e miratimit të lejes së veçantë për personat e burgosur, drejtori i IEVP-së nxjerr urdhrin me shkrim, sipas formatit në shtojcën nr. 9/1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

ç) Drejtori i IEVP-së përcakton në urdhër edhe mënyrën, kushtet, mjetet e shoqërimit të të burgosurit me forcat e policisë së burgjeve dhe numrin e tyre.

d) Për lejet e veçanta pa shoqërim, pas miratimit, i burgosuri pajiset me dy kopje të dokumentacionit “Leja e veçantë”, sipas formatit në shtojcën nr. 10/1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, një kopje të të cilit e dorëzon në komisariatin e policisë që ka në juridiksion vendqëndrimin e tij.

15. Raporti i përbashkët që përgatit sektori ligjor, i sigurisë dhe i kujdesit social, gjatë shqyrtimit të kërkesës për leje të veçantë, sipas Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, hartohet sipas formatit në shtojcën nr. 5 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

16. Leja e veçantë duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesë e të dënuarit sipas formatit në shtojcën nr. 2;

b) urdhër të drejtorit për fillimin e procedurave të shqyrtimit, sipas formatit në shtojcën nr. 7/1;

c) kthim përgjigjeje të burgosurit, sipas formatit në shtojcën nr. 8/2 ose 8/3;

ç) epikrizë mjekësore e të sëmurit;

d) raport të përbashkët të sektorëve përkatës, sipas formatit në shtojcën nr. 5;

dh) aktverifikim të mjekut për epikrizën, sipas formatit në shtojcën nr. 6;

e) raport me shkrim të sektorit të shëndetësisë, sipas formatit në shtojcën nr. 6;

ë) dinamikë të vuajtjes së dënimit;

f) raport paraprak të sektorit të sigurisë për komunikimin me komisariatin, lidhur me rrezikshmërinë e të burgosurit, sipas formatit në shtojcën nr. 12;

g) urdhër për miratimin e lejes, sipas formatit në shtojcën nr. 9/1;

gj) dokumentacion që merr i burgosuri me vete, sipas formatit në shtojcën nr. 10/1;

h) njoftim për drejtorinë e policisë së qarkut dhe për komisariatin që ka në juridiksion vendqëndrimin e të burgosurit, sipas formatit në shtojcën nr. 11;

i) njoftim për drejtorinë e policisë së qarkut dhe për komisariatin që ka në juridiksion vendqëndrimin e të burgosurit, që personi u kthye nga leja, sipas formatit në shtojcën nr. 11;

j) deklaratë e familjarëve, sipas formatit në shtojcën nr. 14.

17. IEVP-ja, menjëherë pas miratimit të lejes së veçantë, njofton me shkrim dhe në komunikim me telefon drejtorinë e policisë së qarkut dhe komisariatin e policisë së rrethit, që ka në juridiksion vendbanimin e të burgosurit, për dhënien e lejes së veçantë të burgosurit, sipas formatit në shtojcën nr. 11, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

18. IEVP-ja njofton me shkrim dhe në komunikim me telefon drejtorinë e policisë së qarkut dhe komisariatin e policisë së rrethit që ka në juridiksion vendbanimin e të burgosurit për kthimin e tij nga leja e veçantë, sipas formatit në shtojcën nr. 11/1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

19. Leja e veçantë pa shoqërim jepet vetëm për të dënuarit që janë trajtuar me leje shpërblyese.

20. Leja e veçantë pa shoqërim jepet për një kohëzgjatje deri në 48 orë. Leja e veçantë mund të zgjatet me kërkesë të të dënuarit edhe me 24 orë të tjera, vetëm për rastet e sëmundjeve të rënda kundrejt dokumentacionit përkatës dhe vetëm me miratim të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

21. Lejet e veçanta për të paraburgosurit jepen në çdo rast me shoqërim dhe vetëm me miratimin paraprak të prokurorit.

22. Leja e veçantë më shoqërim me kohëzgjatje deri në 12 orë miratohet vetëm në kushtet kur ka ndriçim natyral. Drejtori që jep lejen përcakton në urdhrin e dhënies së lejes së veçantë, kushtet, mjetet e shoqërimit të të



burgosurit me forca të policisë së burgjeve dhe numrin e tyre.

V. RREGULLA TË PËRBASHKËTA PËR LEJEN SHPËRBLYESE DHE LEJEN E VEÇANTË

1. Leja shpërblyese apo e veçantë miratohet nga drejtori i IEVP-së, pasi të ketë marrë tri mendime në favor të miratimit të saj, sipas raporteve të përgatitura nga sektorët përkatës, sipas këtij udhëzimi.

2. Sektori i kujdesit social dhe i sigurisë në IEVP, gjatë periudhës së lejeve shpërblyese apo të veçanta, regjistron në një regjistër të posaçëm çdo informacion të marrë, në lidhje me sjelljen e çdo të dënuari. Shënimet e regjistrit administrohen edhe në dosjen personale të të burgosurit.

3. Të gjitha lejet shpërblyese dhe të veçanta të dhëna regjistrohen në një regjistër të veçantë, të krijuar për këtë qëllim, i cili titullohet “Regjistri i lejeve shpërblyese dhe të veçanta të IEVP-së”. Format i këtij regjistri është sipas formatit në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

4. Drejtori i IEVP-së i dërgon drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe ministrit të Drejtësisë, brenda 24 orëve nga miratimi i lejes, njoftimin për dhënien e lejes shpërblyese ose të veçantë dhe brenda 5 ditëve, të gjithë dokumentacionin që ka shërbyer për të miratuar këtë leje, sipas shtojcës 13 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Në fillim të vitit, drejtoritë e IEVP-ve, i dërgojnë drejtorit të Përgjithshëm dhe ministrit të Drejtësisë planifikimin vjetor paraprak të lejeve shpërblyese për të dënuarit.

VI. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Udhëzimi me nr. 103, datë 14.2.2014, “Për rregullimin e disa çështjeve që kanë të bëjnë me procedurën e dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçanta personave të burgosur”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)



Shtojcë nr. 1

REGJISTRI I LEJEVE SHPËRBLYESE DHE TË VEÇANTA TË IEVP-së _____

Nr.	Emri/mbiemri i të burgosurit	Lloji i lejes së dhënë	Masa e dënimit	Dënimi i mbetur	Data e fillimit të lejes	Data e mbarimit të lejes	Shkaku i lejes	Leje e miratuar/e refuzuar
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								
12								
13								
14								
15								
16								
17								
18								
19								
20								
21								
22								
23								
24								
25								



REGJISTRI I KËRKESË-ANKESAVE TË TË BURGOSURVE PËR LEJE SHPËRBLYESE DHE TË VEÇANTË

Nr.	Emër, atësia, mbiemër	Data e protokollimit të kërkesës	Objekti i kërkesë/i ankesës		Miratimi ose refuzimi Po/jo	Data e kthimit të përgjigjes me shkrim	Nënshkrimi
			Shpërblyese	E veçantë			



Shtojcë nr. 2

Datë ____.

KËRKESË

Lënda: Kërkesë për leje _____ (shpërbhysë / apo të veçantë)

Drejtuar: Drejtorit të IEVP-së _____

IEVP _____ (emri i burgut)

Me anë të kësaj kërkesë, unë i nënshkruari _____, bazuar në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, kërkoj leje _____, për _____ ditë (të shërbet edhe me fjalë).

Shkaku ligjor për dhënien e lejes është:

(Sjellja e mirë, sëmundje e rëndë e cila rrezikon jetën e anëtarit të familjes, ngjarje e rëndësishme familjare, si: vdekje, lindje apo martesë.)

Për sa më sipër, mbetem në pritje të përgjigjes suaj.

Me respekt,

Emër/mbiemër
(nënshkrimi)



Shtojcë nr. 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Nr. ____ prot.

Datë ____.

RAPORT I SEKTORIT LIGJOR

Lidhur me kërkesën për leje shpërblyese, të shtetasit/shtetases të dënuar me burgim

z./znj. _____

Drejtuar: Drejtorit të IEVP-së _____

Bazuar në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, ju informoj se shtetasi _____ është dënuar me _____ vjet, _____ muaj, _____ ditë burgimi dhe po vuan dënimin në burgun e sigurisë së (zakonshme/të ulët).

Deri më sot ai ka vuajtur _____ vjet, _____ muaj, _____ ditë burgimi dhe ka për të vuajtur edhe _____ vjet, muaj _____ ditë burgimi. Për rrjedhojë, kërkuesi **plotëson/nuk plotëson kohëzgjatjen e vuajtjes së dënimit për të marrë leje shpërblyese që është (1/4, 1/2, 2/3) e dënimit me burgim.**

Shtetasi _____ ka përfituar _____ ditë lejeje që nga fillimi i vitit dhe leja e fundit shpërblyese është dhënë në datën ____.

Për sa më sipër, meqenëse shtetasi i burgosur _____ plotëson/nuk plotëson kriteret ligjore dhe nënligjore, propozoj t’i jepet/të mos i jepet leje shpërblyese, në masën _____ ditë.

Përgjegjës i Sektorit Ligjor



Shtojcë nr. 4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Nr. prot.

Datë ____.

RAPORT I SEKTORIT TË SHËRBIMIT TË KUJDESIT SOCIAL DHE TË SIGURISË
Mbi vlerësimin e sjelljes për leje shpërblyese të shtetasit/shtetases të dënuar
z. /znj.

Mbështetur në kërkesën e tij/saj për leje shpërblyese

Drejtuar: Drejtorit të institucionit z./znj. _____
 IEV Penale _____

Bazuar në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, gjatë shqyrtimit të kërkesës për leje shpërblyese të shtetasit/ses të dënuar _____, sektori i shërbimit të kujdesit social ju informon se:

Shtetasi/ja _____, i/e cili/a po vuan dënimin me burgim në IEVP ____

1. Ka shfaqur sjellje pozitive, duke mos paraqitur rrezikshmëri shoqërore brenda një viti nga paraqitja e kërkesës.

Po ☐ Jo ☐

Nëse “Jo” sqaro shkaku:

2. Tregon qëndrim korrekt dhe joagresiv në marrëdhëniet me personelin e IEV Penale, si dhe ndaj vizitorëve që hyjnë në institucion dhe nuk ka kryer kundër tyre veprime, që sipas Kodit Penal konsiderohen vepra penale.

Po ☐ Jo ☐

3. Gjatë vuajtjes së dënimit, në mënyrë të vazhdueshme ka marrë pjesë aktive në aktivitetet rehabilituese të organizuara në institucion dhe ka shfaqur ndjenjë përgjegjësie dhe korrektësie.

Po ☐ Jo ☐

4. Shprehet dhe ndjehet i/e penduar për veprën e kryer.

Po ☐ Jo ☐

5. Krijon besimin e një qëndrimi të mirë jashtë institucionit.

Po ☐ Jo ☐

6. Gjatë vuajtjes së dënimit në mënyrë të vazhdueshme ka shfaqur ndjenjë përgjegjësie dhe korrektësie në sjelljen e tij/saj personale, në marrëdhënie me bashkëvuajtësit.

Po ☐ Jo ☐

Nëse “Jo” sqaro:

7. Ka respektuar afatet e rikthimit të tij në institucion pas lejeve të mëparshme të dhëna.

Po ☐ Jo ☐

8. U është bindur urdhrave dhe ka treguar korrektësi në kryerjen e detyrave të caktuara nga personeli i IEV Penale.

Po ☐ Jo ☐

Nëse “Jo” sqaro:

9. Nuk ka nxitur apo nuk është përfshirë në rebelimin (revoltën) e të burgosurve brenda IEV Penale apo në IEVP-të e tjera brenda një viti nga paraqitja e kërkesës.

Po ☐ Jo ☐

Nëse “Jo” sqaro:

10. Nuk ka ofenduar apo nuk ka përdorur dhunë ndaj punonjësve të institucionit, me qëllim pengimin e ushtrimit të detyrës apo të shërbimit.

Po ☐ Jo ☐

11. Nuk ka tentuar më parë të largohet pa leje apo nuk është larguar nga vendi i qëndrimit të tij të detyrueshëm.

Po ☐ Jo ☐

12. Nuk simulon më gjendjen e tij shëndetësore.

Po ☐ Jo ☐

13. Nuk ka kryer akte apo vepra të tjera, të cilat cenojnë dukshëm qetësinë dhe moralin në IEV Penale.

Po ☐ Jo ☐Po ☐ Jo ☐

Nëse “Jo” sqaro:

14. Nuk ka mbajtur ose shpërndarë sende që mund të përdoren për të dëmtuar jetën, shëndetin e personave të tjerë, sigurinë në institucion apo sende personale që janë të ndaluara për t'u mbajtur, në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

Po ☐ Jo ☐

15. Ka treguar kujdes të mirë në administrimin e sendeve apo të pajisjeve të institucionit, duke mos i dëmtuar apo i përvetësuar ato.

Po ☐ Jo ☐

16. Ka treguar kujdes në higjienën dhe pamjen e pastër e të rregullt të tij, si dhe në mbajtjen pastër dhe në mënyrë të rregullt të dhomës dhe ambienteve të përbashkëta.

Po ☐ Jo ☐

17. Nuk ka kryer aktivitete të tjera që janë të ndaluara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, si dhe në rregulloren e brendshme të IEV Penale.

Po ☐ Jo ☐

Nëse “Jo” sqaro:

18. Nuk ka kryer veprime ose mosveprime që kanë cenuar liritë dhe të drejtat themelore të të burgosurve të tjerë.

Nëse “Jo” sqaro:

Për sa më sipër, meqenëse shtetasi/ja i/e dënuar plotëson/nuk plotëson kriteret ligjore dhe nënligjore, propozojmë t'i jepet/të mos t'i jepet leje shpërblyese.

Specialist i Sektorit të Shërbimit të Kujdesit Social

Specialist i Sektorit të Sigurisë

Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit të Kujdesit Social

Përgjegjës i sektorit të sigurisë



Shtojcë nr. 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Nr. prot.

Datë ____ . ____ . ____

RAPORT I PËRBASHKËT I SEKTORËVE LIGJORË, TË SHËRBIMIT TË KUJDESIT
SOCIAL DHE TË SIGURISË

Lidhur me kërkesën për leje të veçantë të shtetasit/ses të burgosur
z./znj.

Drejtuar: Drejtorit të institucionit z./znj. _____
 IEV Penale _____

Bazuar në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, gjatë shqyrtimit të kërkesës për leje të veçantë të shtetasit ____:

1. Sektori ligjor

Ju informoj se shtetasi, i cili po vuan dënimin me burgim në IEV Penale _____ :

1. Ka lidhje të ngushtë familjare ndërmjet personit të burgosur dhe anëtarit të familjes që është i sëmurë, ka vdekur, ka lindur apo martohet: **Po** ☐ **Jo** ☐

2. Lidhja e ngushtë familjare dokumentohet nga certifikata familjare/certifikata e trungut familjar nr. _____, datë _____, lëshuar nga zyra e gjendjes civile, bashkia/komuna. ____

3. Dokumentacioni që vërteton sëmundjen e rëndë, faktin juridik të vdekjes, lindjes apo martesës së anëtarit të familjes së personit të burgosur është:

4. Në rast se leja e veçantë jepet për shkak të sëmundjes së rëndë të anëtarit të familjes, ky fakt vërtetohet nga dokumentacioni që provon sëmundjen e rëndë me nr. _____, datë _____, lëshuar nga spitali publik apo privat _____, ku është trajtuar familjari i sëmurë, i cili duhet të paraqitet brenda 10 ditëve nga data e lëshimit të tij, në emër të familjarit të sëmurë.

Sipas mendimit me shkrim të përgjegjësit të sektorit të shëndetësisë/mjekut në IEVP, lidhur me sëmundjen e rëndë të anëtarit të familjes së të burgosurit, rezulton se kjo sëmundje e rëndë që rrezikon/nuk rrezikon jetën e këtij shtetasi.



5. _____ Deri më sot, ai ka vuajtur vjet, muaj, ditë burgimi dhe ka për të vuajtur edhe _____ vjet, _____ muaj, _____ ditë burgimi.

6. _____ Gjatë këtij viti ka përfunduar leje shpërblyese dhe leje të veçanta _____ .
(të specifikohet kohëzgjatja e lejes dhe numri i ditëve për secilën leje të dhënë).

Për sa më sipër, meqenëse shtetasi i burgosur _____ plotëson/ nuk plotëson kriteret ligjore dhe nënligjore, propozoj t'i jepet/ të mos i jepet leje e veçantë, në masën _____ ditë.

2. Sektori i sigurisë dhe sektori i shërbimit të kujdesit social

Ju informojmë se shtetasi/ja _____ ,
i/e cili/a po vuan dënimin me burgim në IEVP _____ :

1. Ka shfaqur sjellje pozitive, duke respektuar Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve dhe rregulloren e brendshme të institucionit.

Po ☐ Jo ☐

Nëse “Jo”, ka marrë masë disiplinore sipas shkresës nr. _____.

2. Tregon qëndrim korrekt dhe joagresiv në marrëdhëniet me personelin e IEV Penale, si dhe ndaj vizitorëve që hyjnë në institucion dhe nuk ka kryer kundër tyre veprime, që sipas Kodit Penal konsiderohen vepra penale.

Po ☐ Jo ☐

3. Gjatë vuajtjes së dënimit në mënyrë të vazhdueshme ka marrë pjesë aktive në aktivitetet rehabilituese të organizuara në institucion dhe ka shfaqur ndjenjë përgjegjësie dhe korrektësie.

Po ☐ Jo ☐

4. Shprehet dhe ndihet i/e penduar për veprën e kryer.

Po ☐ Jo ☐

5. Nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore dhe krijon besimin e një qëndrimi të mirë jashtë institucionit.

Po ☐ Jo ☐

6. Gjatë vuajtjes së dënimit, në mënyrë të vazhdueshme ka shfaqur ndjenjë përgjegjësie dhe korrektësie në sjelljen e tij/ saj personale, në marrëdhënie me bashkëvuajtësit.

Po ☐ Jo ☐

7. Ka respektuar afatet e rikthimit të tij në institucion pas lejeve të mëparshme.

Po ☐ Jo ☐

8. Nuk ka nxitur apo nuk është përfshirë në rebelimin (revoltën) e të burgosurve në IEV Penale apo në IEVP-të e tjera brenda një viti nga paraqitja e kërkesës.

Po ☐ Jo ☐

9. Nuk ka ofenduar apo nuk ka përdorur dhunë ndaj punonjësve të institucionit, me qëllim pengimin e ushtrimit të detyrës apo të shërbimit.

Po ☐ Jo ☐

10. Nuk ka mbajtur ose shpërndarë sende që mund të përdoren për të dëmtuar jetën, shëndetin e personave të tjerë, sigurinë në institucion apo sende personale, që janë të ndaluara për t'u mbajtur, në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

Po ☐ Jo ☐

11. Nuk ka tentuar më parë të largohet pa leje apo nuk është larguar nga vendi i qëndrimit të tij të detyrueshëm.

Po ☐ Jo ☐

12. Nuk ka kryer akte apo vepra të tjera, të cilat cenojnë dukshëm qetësinë dhe moralin në IEV Penale.

Po ☐ Jo ☐

13. Nuk ka kryer veprime ose mosveprime që kanë cenuar liritë dhe të drejtat themelore të të burgosurve të tjerë.

Po ☐ Jo ☐

Për sa më sipër, meqenëse shtetasi/ja i burgosur plotëson/ nuk plotëson kriteret ligjore dhe nënligjore, propozojmë t'i jepet/mos t'i jepet leje e veçantë.

Përgjegjës i Sektori Ligjor

Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit të Kujdesit Social

Përgjegjës i Sektorit të Sigurisë



Shtojcë nr. 6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Nr. _____ prot.

Datë ____ . ____ . ____

RAPORT ME SHKRIM I SEKTORIT SHËNDETËSISË

Mbi vlerësimin e epikrizës së paraqitur për leje të veçantë dhe dhënie mendimi për
sëmundjen e familjarëve të të burgosurit

Drejtuar: Drejtorit të të institucionit z./znj. _____
IEV Penale _____

Bazuar në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, në kërkesën e të dënuarit _____ në dokumentin shëndetësor, eprikizën mjekësore, më datë _____, në pavionin _____, që për të sëmurin _____, lëshuar nga spitali publik apo privat ku është trajtuar familjari i sëmurë, i cili duhet të paraqitet brenda 10 ditëve nga data e lëshimit të tij në emër të familjarit të sëmurë të të burgosurit _____.

Epikriza (dokumenti mjekësor) i paraqitur është/nuk është brenda kërkesave të udhëzimit të ministrit të Drejtësisë (në rast se jo, të jepen sqarimet e mungesave).

Mbi bazën dokumentacionit të paraqitur rezulton se bëhet fjalë për një shtrim në spital më datë _____, në pavionin _____ (jepen të dhëna që konfirmojnë sëmundjen dhe gjendjen momentale të të sëmurit).

U kontaktua nga unë me telefonin e sektorit të informacionit, me numrat e telefonit të mjekëve që trajtonin të sëmurin, ku u mor informacioni se _____
(jepet sqarimi për bisedën e bërë).

Sipas dokumentacionit të paraqitur dhe bisedës së kryer, rezulton se shtetasi vuan nga sëmundje e rëndë.

Pas vlerësimit të këtyre të dhënave, jam i mendimit se sëmundja që pasqyrohet në këtë dokument është /nuk është sëmundje e rëndë që rrezikon/ nuk rrezikon jetën e këtij shtetasi, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.

Ky mendim me shkrim, lidhur me sëmundjen e anëtarit të familjes së të burgosurit, i bashkëlidhet dokumentacionit që shoqëron kërkesën për leje të veçantë.

Përgjegjës i Sektorit të Shëndetësisë/mjeku në IEVP



Shtojcë nr. 7



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Nr. _____ prot.

Datë ____ . ____ . ____

URDHËR

Nr. _____, datë _____

Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës për leje shpërblyese për të dënuarin

Mbështetur në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve dhe në kërkesën e të dënuarit me nr. _____, datë _____,

URDHËROJ:

1. Sektorin ligjor, sektorin e kujdesit social dhe sektorin e ruajtjes dhe të sigurisë të shqyrtojnë kërkesën për leje shpërblyese të të dënuarit dhe të përgatisin raportet përkatëse, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore.
2. Përgjegjësi i sektorit ligjor përgatit brenda afateve ligjore raportin e detajuar të shërbimit ligjor mbi gjendjen e tij gjyqësore, si dhe dinamikën për vuajtjen e dënimit.
3. Përgjegjësi i sektorit të kujdesit social dhe përgjegjësi i sektorit të ruajtjes dhe të sigurisë përgatit brenda afateve ligjore raport të detajuar lidhur me gjendjen e tij sociale dhe të sigurisë.
4. Afati për zbatimin e këtij urdhri është 5 ditë nga dita e marrjes e tij.
5. Moszbatimi i këtij urdhri ngarkon me përgjegjësi personat përgjegjës.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I IEVP-së



Shtojcë nr. 7/1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Nr. _____ prot.

Datë _____._____._____

URDHËR

Nr. _____, datë _____

Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës për leje të veçantë për të burgosurin

Mbështetur në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, dhe në kërkesën e të dënuarit me nr. _____, datë _____,

URDHËROJ:

1. Sektorin ligjor, sektorin e kujdesit social dhe sektorin e ruajtjes dhe të sigurisë të shqyrtojnë kërkesën për leje të veçantë të të dënuarit dhe të japin të dhëna, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore.
2. Përgjegjësi i sektorit ligjor, përgjegjësi i sektorit të kujdesit social dhe përgjegjësi i sektorit të ruajtjes dhe të sigurisë të përgatisin brenda afateve ligjore raportin e përbashkët mbi gjendjen e tij gjyqësore, sociale dhe të sigurisë.
3. Përgjegjësi i sektorit ligjor të përgatisë dinamikën e vuajtjes së dënimit.
4. Afati për zbatimin e këtij urdhri është 1 (një) ditë nga dita e marrjes së këtij urdhri.
5. Moszbatimi i këtij urdhri ngarkon me përgjegjësi personat përgjegjës. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I IEVP-së



Shtojcë nr. 8



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Nr. _____ prot.

Datë ____ . ____ . ____

Lënda: Kthim përgjigjeje/leje shpërblyese**Drejtuar:** Të dënuarit _____

Në përgjigje të kërkesës nr. _____ , datë , si dhe mbështetur në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, ju informojmë se kërkesa është refuzuar.

Shkaku ligjor për refuzimin e lejes është:

Me plotësimin e kriterëve ligjorë do të bëjmë të mundur planifikimin tuaj, për leje shpërblyese në vazhdim. Kundër këtij vendimi të drejtorit të institucionit mund t'i drejtoheni gjykatës së vendit ku ndodhet institucioni.

DREJTOR I IEVP-së



Shtojcë nr. 8/1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Nr. ____ prot.

Datë ____ . ____ . ____

Lënda: Kthim përgjigjeje/ leje shpërblyese

Drejtuar: Të dënuarit

Në përgjigje të kërkesës suaj nr. ____ ____, datë ____, si dhe mbështetur në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, ju informojmë se:

Jeni planifikuar për leje shpërblyese në muajin _____.

Stafi përgjegjës i institucionit përgjatë kësaj periudhe vëzhgon dhe regjistron sjelljen tuaj dhe merr masa në përputhje me kriteret ligjore deri në anulimin e planifikimit për të përfituar lejen shpërblyese.

DREJTOR I IEVP-së



Shtojcë nr. 8/2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Nr. ____ prot.

Datë ____ . ____ . ____

Lënda: Kthim përgjigjeje/ leje të veçantë

Drejtuar: Të burgosurit _____

Në përgjigje të kërkesës suaj nr. ____ prot., datë _____, si dhe mbështetur në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve,

Shkaku ligjor për refuzimin e lejes është _____
_____.

Kundër këtij vendimi të drejtorit të institucionit mund t'i drejtoheni gjykatës së vendit ku ndodhet institucioni.

DREJTOR I IEVP-së



Shtojcë nr. 8/3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Nr. ____ prot.

Datë ____ . ____ . ____

Lënda: Kthim përgjigjeje/leje e veçantë

Drejtuar: Të burgosurit

Në përgjigje të kërkesës suaj nr. ____, datë ____, si dhe mbështetur në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, ju informojmë se:

Ju është miratuar leja e veçantë kërkuar për arsye të

_____.

DREJTOR I IEVP-së



Shtojcë nr. 9



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

URDHËR

Nr. , datë _____

Për miratimin e lejes shpërblyese për të dënuarin

Mbështetur në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, në kërkesën e të dënuarit nr.____, datë _____, në shkresës me nr.____, datë _____, të DPB-së për planifikimin e lejes shpërblyese për të dënuarin, si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga shërbimet përkatëse:

- Shërbimi ligjor, sipas raportit të paraqitur, është ose jo dakord **Po** ☐ **Jo** ☐
- Shërbimi i kujdesit social, sipas raportit të paraqitur, është ose jo dakord **Po** ☐ **Jo** ☐
- Shërbimi i ruajtjes dhe i sigurisë, sipas raportit të paraqitur është ose jo dakord **Po** ☐ **Jo** ☐

URDHËROJ:

1. Miratimin **Po** ☐ ose **Jo** ☐ të lejes shpërblyese për të burgosurin _____, i biri i _____ dhe i _____, i datëlindjes _____, i lindur në _____, banues në _____, me shtetësi _____, është dënuar me _____ vjet, _____ muaj, _____ ditë, për veprën penale _____, të parashikuar në nenin _____ të Kodit Penal, ardhur në institutin më datë _____, nga _____.

Është arrestuar më datë _____, ka përfutur ulje dënimi _____ me punë, _____ me amnisti.

Gjithsej ka vuajtur _____, i kanë mbetur për të vuajtur _____, sigurie _____.

2. Leja shpërblyese jepet nga ora _____ e datës _____ deri në orën _____ të datës.

3. Vendqëndrimi i të dënuarit do të jetë _____.

4. Leja nga ana e të dënuarit duhet të kryhet detyrimisht në vendin e caktuar në këtë urdhër.

5. Për çdo shmangie të kësaj lejeje, të imponuar nga forca madhore, i dënuari duhet të njoftojë në numrin e telefonit _____ të informacionit të IEV Penale _____.

6. Mosrespektimi i rregullave dhe i kushteve të përcaktuara në këtë urdhër ngarkon personin me përgjegjësi penale, në bazë të nenit 323 të Kodit Penal.



7. Ky urdhër shfuqizohet nëse i dënuari, pas daljes së urdhrit ndëshkohet me masë disiplinore nga këshilli disiplinor, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

8. Transporti i të dënuarit do të bëhet ose jo me shpenzimet e institucionit: Po ☐ Jo ☐

9. Sektori i informacionit do të bëjë njoftimin në komisariatit e policisë së vendqëndrimit të të dënuarit dhe në Drejtorinë e Përgjithshme e Burgjeve.

10. Ky urdhër përpilohet në 5 kopje dhe hyn në fuqi në ditën e përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

DREJTOR I IEVP-së

I DËNUARI

(u njoha me këtë urdhër)



Shtojcë nr. 9/1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

URDHËR

Nr.____, datë _____._____

Për miratimin e dhënies së lejes së veçantë për të dënuarin

Mbështetur në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve dhe në kërkesën e të dënuarit nr. _____, datë _____, si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga shërbimet përkatëse:

- Shërbimi ligjor, sipas raportit të paraqitur. është ose jo dakord: **Po** ☐ **Jo** ☐
- Shërbimi i kujdesit social, sipas raportit të paraqitur. është ose jo dakord: **Po** ☐ **Jo** ☐
- Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë, sipas raportit të paraqitur. është ose jo dakord: **Po** ☐ **Jo** ☐

URDHËROJ:

1. Miratimi **Po** ☐ ose **Jo** ☐ të lejes së veçantë për të burgosurin _____, i biri i _____ dhe i _____, i datëlindjes _____, lindur _____, banues _____, i _____, me shtetësi _____, është dënuar me _____ vjet, _____ muaj/dite, për veprën penale _____ të parashikuar në nenin _____ të Kodit Penal, ardhur në institucion më datë _____, nga _____. Është arrestuar, ka përfituar ulje dënimi _____, me pune _____, me amnisti _____. Gjithsej, të vuajtura _____, mbetur për të vuajtur _____, siguria e _____.

2. Leja e veçantë i jepet nga ora _____ e datës _____ deri në orën _____ të datës _____, me/pa shoqërim.

3. Shkaku i dhënies së lejes është _____.

4. Vendqëndrimi i të dënuarit do të jetë _____.

5. Leja nga ana e të dënuarit duhet të kryhet detyrimisht në vendin e caktuar në këtë urdhër.

6. Për çdo shmangie të kësaj lejeje, të imponuar nga forca madhore i dënuari duhet të njoftojë në numrin e telefonit _____ të informacionit të IIEV Penale.



7. Mosrespektimi i rregullave dhe i kushteve të përcaktuara në këtë urdhër ngarkon personin me përgjegjësi penale në bazë të nenit 323 të Kodit Penal.
8. Ky urdhër shfuqizohet nëse i dënuari pas daljes së urdhrit ndëshkohet me masë disiplinore nga këshilli disiplinor, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
9. Transporti i të dënuarit do të bëhet ose jo me shpenzimet e institucionit: **Po** ☐ **Jo** ☐
10. Sektori i Informacionit do të bëjë njoftimin në komisariatit e policisë së vendqëndrimit të të dënuarit dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
11. Ky urdhër përpilohet në 5 kopje dhe hyn në fuqi në ditën e përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

DREJTOR I IEVP-së

I DËNUARI

(u njoha me këtë urdhër)



Shtojcë nr. 10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale_____

Nr. _____ prot.

Datë ____ . ____ . ____

LEJE SHPËRBLYESE**Për të dënuarin**

Mbështetur në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, të ndryshuar:

1. Ju i dënuari/a _____, keni përfituar leje shpërblyese nga ora ____ e datës ____ deri në orën ____ të datës ____.
2. Vendqëndrimi i juaj është në _____.
3. Leja nga ana juaj duhet të kryhet detyrimisht në vendin e caktuar në këtë urdhër.
4. Për çdo shmangie të kësaj lejeje, të imponuar nga forca madhore, ju duhet të njoftoni në numrin e _____ të informacionit të IEV Penale _____.
5. Ju, i dënuari në datën _____, duhet të paraqiteni bashkë me një kopje të shkresës “Leje shpërblyese” në komisariatën e policisë së vendqëndrimit.
6. Në ditët e tjera, i trajtuar me leje shpërblyese, ju duhet të paraqiteni në komisariatën e policisë së vendqëndrimit tuaj çdo ditë në orën _____.
7. Mosrespektimi i rregullave dhe kushteve të përcaktuara më sipër ngarkon personin me përgjegjësi penale në bazë të nenit 323 të Kodit Penal.
8. Ky urdhër përpilohet në 2 kopje.

I DËNUARI

DREJTOR I IEVP-së



Shtojcë nr. 10\1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Nr. ____ prot.

Datë ____ . ____ . ____

LEJE E VEÇANTË

Për të burgosurin

Mbështetur në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, të ndryshuar:

1. Ju i dënuari/a _____, keni përfituar leje të veçantë nga ora ____ e datë ____ deri në orën ____ të datës _____, me /pa shoqërim.
Shkaku i dhënies së lejes është _____.
2. Vendqëndrimi i juaj është në _____.
3. Leja nga ana juaj duhet të kryhet detyrimisht në vendin e caktuar në këtë urdhër.
4. Për çdo shmangie të kësaj lejeje, të imponuar nga forca madhore, ju duhet të njoftoni në numrin e telefonit _____ të informacionit të IEV Penale _____.
5. Ju, i dënuari në datën _____, duhet të paraqiteni bashkë me një kopje të shkresës “Leje të veçantë” në komisariatën e policisë së vendqëndrimit.
6. Në ditët e tjera, i trajtuar me leje të veçantë, ju duhet të paraqiteni në komisariatën e policisë së vendqëndrimit tuaj çdo ditë në orën _____.
7. Mosrespektimi i rregullave dhe kushteve të përcaktuara më sipër ngarkon personin me përgjegjësi penale në bazë të nenit 323 të Kodit Penal.
8. Ky urdhër përpilohet në 2 kopje.

I DËNUARI

DREJTOR I IEVP-së



Shtojcë nr. 11



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Nr. ____ prot.

Datë ____ . ____ . ____

Lënda: Informacion për dhënie të lejes ____ të burgosurit**Drejtuar:** Komisarariatit të policisë së ____

Mbështetur në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, ju njoftojmë se:

I burgosuri ____, i dënuar me ____ vjet, ____ muaj, ____ ditë, për veprën penale të parashikuar në nenin ____ të Kodit Penal, ka përfutur leje shpërblyese/veçantë nga ora ____, datë ____ deri në orën ____, datë ____.

Shkaku i dhënies së lejes është ____.

Vendqëndrimi i tij është në ____.

I dënuari është informuar të paraqitet në komisaratin e policisë në datën ____ dhe çdo ditë të trajtimit me leje shpërblyese në orën ____.

Mosrespektimi i rregullave dhe kushteve të përcaktuara më sipër nga ana e të burgosurit ju ngarkon të merrni masa dhe të njoftoni menjëherë informacionin e IEV Penale ____.

DREJTOR I IEVP-së



Shtojcë nr. 11/1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Nr. ____ prot.

Datë ____ . ____ . ____

Lënda: Njoftim për kthimin e të burgosurit _____**Drejtuar:** Komisarariatit të Policisë së _____

Mbështetur në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, ju njoftojmë se:

I burgosuri _____, i dënuar me ____ vjet, ____ muaj, ____ ditë, për veprën penale të parashikuar në nenin _____ të Kodit Penal, kishte përfituar leje shpërblyese/të veçantë nga ora _____, datë _____ deri në orën _____, datë _____, është kthyer në IEV Penale, sipas kritereve ligjore/në shkelje të kritereve ligjore, me argumentin _____.

DREJTOR I IEVP-së



Shtojcë nr. 12



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Nr. ____ prot.

Datë ____ . ____ . ____

Lënda: Raport paraprak i sektorit të sigurisë për të burgosurin _____,
me objekt “Për miratimin e lejes së veçantë”

Drejtuar: Drejtorit të IEVP-së _____

Mbështetur në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, ju njoftojmë se:

Është komunikuar me komisariatit e vendqëndrimit ku ndodhet i burgosuri, i dënuar me ____ vjet, ____ muaj, ____ ditë, për veprën penale të parashikuar në nenin të Kodit Penal, i cili ka bërë kërkesë për leje të veçantë nga ora ____, datë _____ deri në orën ____, datë _____.

Është informuar për qëndrimin korrekt ose agresiv në marrëdhëniet në institucion, për paraqitjen e rrezikshmërisë shoqërore dhe besimin e tij jashtë qëndrimit nga institucioni, tentativat e tij të mëparshme për të larguar nga vendi i qëndrimit, si dhe nëse ka respektuar afatin për lejet e dhëna më parë.

Nga ana e komisariatit m’u dha informacioni që ata kishin në lidhje me të burgosurin, marrëdhëniet shoqërore të tij, problemet, hasmëritë, lidhjet problematike etj., si dhe mbi mundësitë e komisariatit për të pasur nën mbikëqyrje të burgosurin gjatë ditës (ditëve) që është me leje të veçantë.

Mbi bazën e këtyre informacioneve, ju propozoj që të burgosurit _____.

Përgjegjës i Sektorit të Sigurisë
(emër, mbiemër, nënshkrimi)



Shtojcë nr. 13



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Nr. ____ prot.

Datë ____ . ____ . ____

Lënda: Informacion për lejen shpërblyese dhe të veçanta gjatë muajit _____ dhe planifikimi për muajin _____

Drejtuar: Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve _____

Për dijeni: Ministrit të Drejtësisë _____

I nderuar _____,

Gjatë muajit (____), në IEVP _____, u dhanë leje shpërblyese dhe _____ leje të veçanta.

Bashkëngjitur lista e personave që kanë qenë me leje shpërblyese dhe të veçanta (emër, atësi mbiemër, vepra e kryer, dënuar, kryer, banues, data kur iu dha leja).

Në muajin (____) janë dhënë leje shpërblyese jashtë planifikimit të muajit paraardhës. Arsytet e dhënies së këtyre lejeve janë:

Për muajin (____) u takonte ligjërisht (kishin plotësuar afatet) _____ të burgosur:

Nga këto kishin bërë kërkesë për leje _____ të burgosur.

Nuk u është miratuar leja, pavarësisht se kishin plotësuar afatet dhe ishin të planifikuar të burgosurve: _____

Arsyet kryesore të mosdhënies së lejeve ishin

Numri total i ditëve me leje me leje të dhëna për të gjithë të burgosurit për muajin (____) ishte _____ ditë.

Me shoqërim janë dërguar _____ të burgosur.

Problemet kryesore gjatë muajit (____) në dhënien e lejeve për të burgosurit ishin:

- *jepen personat që u vonuan;*

- *personat që nuk u kthyen.*

Për muajin (____) u takon ligjërisht (plotësojnë afatet) _____ të burgosur.

Nga këta kanë bërë kërkesë _____ të burgosur.

Bashkëngjitur është lista e planifikimeve për leje për muajin (dhjetor) (emër, atësi mbiemër), vepra e kryer, dënuar, kryer, banues, data kur iu është dhënë leja e fundit).

DREJTOR I IEVP-së
(emër, mbiemër, nënshkrimi)



Shtojcë nr. 14

DEKLARATË

Unë i nënshkruari _____, familjari i të burgosurit _____, me vendbanim në _____, me dokument identifikues me _____ nr. _____, deklaroj nën përgjegjësinë time për vërtetësinë dhe autencitetin e dokumentacionit që dorëzoja sot, në datë _____, ora _____, pranë IEVP-së _____, lidhur me kërkesën për leje të veçantë për të burgosurin _____.

Për çdo rast komunikoni me numrin e telefonit _____.

(emër, atësi, mbiemër)

URDHËR

Nr. 364, datë 24.12.2020

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR ZHVILLIMIN E MATURËS
SHTETËRORE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJMË:

1. Miratimin e Rregullores për Zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Urdhri nr. 537, datë 8.11.2019, “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore 2020 në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, zëvendesministri i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional

dhe Kualifikimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore arsimore dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimi Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Anila Denaj

**RREGULLORE
PËR ZHVILLIMIN E MATURËS
SHTETËRORE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1**Objekti i rregullores**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave, detyrave dhe përgjegjësi të institucioneve shtetërore për organizimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe i të drejtave dhe detyrave të individëve që përfshihen në administrimin e realizimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale.



Neni 2 Përkufizime

Në këtë rregullore, shkurtimet dhe përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) “MASR” është Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

b) “Maturë Shtetërore” (më poshtë “Maturë”), është një standard i njësuar provimesh, nga të cilat tri të detyruara dhe një me zgjedhje të detyruar (më poshtë “me zgjedhje”), i cili vërteton përfundimin e shkollës së mesme.

c) “Shkollë e mesme” është institucioni i arsimit të mesëm të lartë.

d) “Shkollë e mesme profesionale” është institucioni i arsimit të mesëm të lartë profesional

e) “IAL” është institucioni i arsimit të lartë.

f) “QSHA” është Qendra e Shërbimeve Arsimore.

g) “ASCAP” është Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar.

h) “RASH” është Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar.

i) “DPAP” është Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

j) “DRAP” është Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar.

k) “ZVA” është Zyra Vendore Arsimore.

l) “AKAFPK” është Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

m) “KMSH” është Komisioni i Maturës Shtetërore në ZVA.

n) “KSHMSH” është Komisioni Shkollor i Maturës Shtetërore.

o) “Qendra e provimit” është institucioni ku zhvillojnë provimin një ose më shumë shkolla të mesme.

p) “Mjedisi i provimit” është salla, palestra etj., ku një numër i caktuar maturantësh/kandidatësh zhvillojnë provimin.

q) “PAP” është përgjegjësi i administrimit të qendrës së provimit.

r) “AP” është administratori i mjedisit të provimit.

s) “PK” është përgjegjës kati.

t) “AS” është administratori i sekretimit të testeve të provimit.

u) “OS”, është oficeri i sigurisë, përfaqësues i MASR në qendrën e provimit.

v) “KOEPS” është koha e ekspozimit potencial të sekretit, referuar periudhës së hartimit, shumëfishimit dhe shpërndarjes së testit, deri në përfundimin e provimit përkatës.

w) “KOPOTED” është komisioni i posaçëm për shqyrtimin e testeve që dyshohen për kopjim.

x) “Komisioni” është Komisioni i Posaçëm për njëvlershmërinë e dëftesave/diplomave të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë vendit.

y) “Maturant” është individ që vazhdon vitin e fundit të shkollës së mesme ose e ka përfunduar atë, por nuk ka marrë dëftesë pjekurie apo diplomë të Maturës (në vijim “diplomë”).

z) “Kandidat” është individ që ka mbaruar Maturën Shtetërore përpara vitit kur po aplikohet Matura Shtetërore dhe ka fituar diplomën e maturës/dëftesën e pjekurisë.

aa) “KOMSH” është Komiteti i Maturës Shtetërore.

bb) Portali “Matura Shtetërore online” është sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të administrojë:

i. procedurat e aplikimit me formularët A1 dhe A1Z të maturantëve/kandidatëve të Maturës Shtetërore;

ii. digjitalizimin e rezultateve të këtyre provimeve;

iii. prodhimin e diplomës së Maturës Shtetërore.

cc) Portali “Maturanti” është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të kryejë:

i. procesin e regjistrimit dhe administrimit të rezultateve të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë të maturantëve/kandidatëve që kanë plotësuar formularin e aplikimit A1 ose A1Z në portalin “Matura Shtetërore online”;

ii. ndërveprimin me portalin “U-Albania”, nëpërmjet përcjelljes në RASH të bazës së plotë të të dhënave të maturantëve/kandidatëve aplikues me formularët A1/A1Z;

iii. prodhimin e certifikatës së Maturës Shtetërore.

Neni 3 Vlefshmëria

Kjo rregullore është e vlefshme dhe zbatohet për dy sesionet e provimeve të Maturës Shtetërore.



KREU II INSTITUCIONET DHE STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS

Neni 4

Institucionet dhe strukturat përgjegjëse

Institucionet dhe strukturat përgjegjëse për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore, janë:

- a) Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- b) Komiteti i Maturës Shtetërore.
- c) Qendra e Shërbimeve Arsimore.
- d) Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar.
- e) Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.
- f) Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar.
- g) Zyra Vendore Arsimore.
- h) Komisioni i Maturës Shtetërore në ZVA.
- i) Komisioni Shkollor i Maturës Shtetërore.
- j) Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.
- k) Institucionet e arsimit të mesëm të lartë.

Neni 5

Detyrat e Komitetit të Maturës Shtetërore

Detyrat e KOMSH-it janë të përcaktuara në urdhrin përkatës të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Neni 6

Detyrat e Qendrës së Shërbimeve Arsimore

Qendra e Shërbimeve Arsimore kryen këto detyra:

- a) Trajnon anëtarët e KMSH të ZVA.
- b) Siguron, në bashkëpunim me KMSH të ZVA, plotësimin dhe përputhshmërinë e kushteve të qendrave dhe mjediseve ku do të zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore.
- c) Administron, përmes portalit të Maturës Shtetërore online, bazën e të dhënave të maturantëve/kandidatëve pjesëmarrës në Maturë.
- d) U krijon akses, përmes portalit “Maturanti”, drejtorive të shkollave të mesme për regjistrimin në bazën e të dhënave të rezultateve lëndore me notë

të thjeshtë dhe/ose me notë të shkallëzuar, për të gjitha vitet e shkollimit të arsimit të mesëm të lartë, për të gjithë maturantët/kandidatët e tyre. Gjithashtu, përmes këtij portalit, kryhet gjenerimi dhe printimi i certifikatave të Maturës Shtetërore për maturantët që diplomohen këtë vit shkollor.

e) Publikon materiale informuese dhe ndihmëse për provimet e Maturës.

f) Siguron fondin e nevojshëm të pyetjeve për çdo provim të Maturës.

g) Siguron testin/testet për secilin maturant/kandidat, sipas formularit përkatës A1/A1Z dhe më pas i mbyll ato në kuti të veçanta për çdo qendër provimi.

h) Merr në dorëzim testet pas përfundimit të çdo provimi.

i) Harton grafikun e shpërndarjes nga Posta Shqiptare të materialeve të provimeve të Maturës.

j) Përzgjedh vlerësuesit e testeve, i trajnon dhe i certifikon ata.

k) Organizon dhe mbikëqyr procesin e vlerësimit të testeve.

l) Organizon hedhjen e të dhënave në sistemin kompjuterik për testet e vlerësuara.

m) Informon çdo ZVA për rezultatet e provimeve të Maturës të maturantëve/kandidatëve të shkollave përkatëse, si dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin profesional, për shkollat e arsimit profesional.

n) Pranon kërkesat në portalin qeveritar “e-albania” të maturantëve/kandidatëve, duke u dërguar atyre kopjet elektronike të testeve të vlerësuara.

o) Arkivon të gjitha materialet e provimeve dhe i ruan ato për 6 (gjashtë) muaj.

p) Ruan në formë elektronike dhe administron të gjitha të dhënat e procesit.

q) Lëshon diplomën e Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale për të gjithë maturantët/kandidatët. Deri më datën 5 korrik, lëshohen diplomat për maturantët që do të studiojnë jashtë vendit.

Neni 7

Detyrat e Komisionit të Maturës Shtetërore në ZVA

KMSH-ja përbëhet nga 3–5 anëtarë dhe drejtohet nga drejtori i ZVA-së. KMSH-ja kryen këto detyra:



a) Organizon ngritjen e KSHMSH-së brenda muajit nëntor.

b) Siguron zbatimin e akteve nënligjore të adresuara për provimet e Maturës Shtetërore.

c) Koordinon veprimtaritë ndërmjet MASR-së, QSHA-së dhe KSHMSH-së.

d) Dërgon zyrtarisht në QSHA dhe në DRAP (të printuar dhe në version elektronik), dy ditë pas përfundimit të shkollës, listën e maturanëve që nuk mund të japin provimet e maturës, si rezultat i mos përfundimit me sukses të vitit të fundit të shkollës së mesme.

e) Lëshon vërtetimin me notat e maturës për çdo kandidat që do të regjistrohet me A1Z në Maturën Shtetërore dhe dërgon në QSHA dhe në DRAP listën e kandidatëve të regjistruar me A1Z, ku janë të pasqyruara të gjitha të dhënat mbi të cilat janë të printuara vërtetimet e lëshuara për çdo rast.

f) Trajnon anëtarët e KSHMSH-së, kontrollojnë dhe vlerësojnë gjendjen teknike të infrastrukturës elektronike në dispozicion të procesit.

g) Organizon dhe monitoron plotësimin e bazës së të dhënave në sistemet informatike online për të gjitha shkollat e ZVA-së përkatëse.

h) Ngre komisionin shkollor në shkollën e autorizuar nga ZVA-ja përkatëse, për hedhjen e notave për të gjitha vitet e arsimit të mesëm të kryer jashtë shtetit nga shtetas shqiptarë dhe të huaj, sipas dokumentacionit të përgatitur nga Komisioni i Posaçëm.

i) Bën ndryshimet në sistem, duke evidentuar maturanët mbetës dhe ia dërgon të printuara si dhe në formë elektronike QSHA, bazuar në informacionin e përcjellë nga KSHMSH-ja.

j) Verifikon dhe siguron përputhshmërinë e kushteve të mjediseve ku do të zhvillohen provimet e Maturës me ato të përcaktuara në këtë rregullore.

k) Harton listën e përgjegjësve të administrimit të provimit, përgjegjësve të katit, administratorëve të provimit dhe administratorëve të sekretimit të testeve të Maturës.

l) Trajnon përgjegjësit e administrimit të provimit, përgjegjësit e katit, administratorët e provimit dhe administratorët e sekretimit të testeve të Maturës.

m) Hedh shortin dy orë para zhvillimit të çdo provimi, në prani të përfaqësuesit të MASR, për caktimin e përfaqësuesve të KMSH-së, PAP-së, PK-së, AS-së dhe AP-së për çdo mjedis provimi të Maturës. Përfaqësuesi i KMSH-së, në një qendër

provimi mbështet PAP, për organizimin e provimit deri para hapjes së kutisë. Më pas largohet dhe i ndalohet të qëndrojë në qendrën e provimit gjatë kohës që zhvillohet provimi.

n) Dorëzon në QSHA, në formë shkresore dhe elektronike, brenda pesë ditëve pas çdo provimi, listën e plotë të emrave të PAP-së dhe AP-së, PK-së dhe AS-së për çdo mjedis.

o) Dërgon në QSHA, brenda datës së përcaktuar nga QSHA-ja, listën e qendrave për provimet e Maturës Shtetërore.

Neni 8

Detyrat e Komisionit Shkollor të Maturës Shtetërore

KSHMSH-ja, në varësi të numrit të maturanëve të shkollës, përbëhet nga 3–5 anëtarë me kryetar drejtorin e shkollës. Në përbërje janë një zëvendësudrejtor dhe mësues të shkollës. KSHMSH-ja kryen këto detyra:

a) Publikon në mjediset e shkollës të gjithë informacionin për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore.

b) Ndihmon dhe sqaron çdo maturan/kandidat për procedurat e zhvillimit të procesit të Maturës Shtetërore.

c) Ndihmon dhe sqaron çdo maturan/kandidat, në kuadër të këshillimit të karrierës, për procedurat dhe kriteret e pranimit në IAL.

d) Koordinon dhe mbështet IAL-në në realizimin e veprimtarive jashtë institucionit arsimor me maturanët, me qëllim njohjen e IAL dhe informimin për programet e studimit të ofruara prej tyre.

e) Monitoron të gjithë procesin e plotësimit online të formularëve A1/A1Z, si dhe shkarkon nga sistemi, listën e maturanëve që kanë plotësuar këta formularë (në dy kopje), të cilët i përcjell zyrtarisht në ZVA.

f) Koordinon me mësuesit kujdestar plotësimin e tabelave ku janë hedhur emrat e maturanëve/kandidatëve me të dhënat personale dhe lëndën e zgjedhur në formularin A1/A1Z.

g) Monitoron, drejton dhe realizon procesin e regjistrimit në portalin “Maturanti” të rezultateve lëndore për të gjitha vitet e shkollimit të arsimit të mesëm të lartë për të gjithë maturanët/kandidatët.



h) Gjeneron dhe printon certifikatat e Maturës Shtetërore për maturantët e diplomuar.

i) Shpall listën përfundimtare të maturantëve/kandidatëve që do të vazhdojnë procesin e maturës.

j) Raporton në KMSH, një ditë pas përfundimit të shkollës, maturantët që nuk mund të vazhdojnë procesin e Maturës si rezultat i mospërfundimit me sukses të vitit të fundit të shkollës së mesme.

k) Shpall listën e mjediseve ku do të zhvillohen provimet dhe informon për këtë çdo maturant/kandidat.

l) Përgatit/kontrollon mjediset e provimeve 24 orë përpara çdo provimi. Drejtori i shkollës, i cili është edhe në cilësinë e kryetarit të KSHMSH-së, do bëjë certifikimin e mjedisit një ditë para provimit të maturës dhe nëse mjedisi i provimit në ditën e provimit është në kundërshtim me rregulloren e MSH, për drejtorin e shkollës do të merren masa administrative sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

m) Plotëson brenda datës së përcaktuar nga QSHA-ja, bazën e të dhënave për maturantët/kandidatët për të gjitha vitet e shkollës së mesme, me përjashtim të vitit të fundit. Secilit maturant/kandidat i jepet një kopje e printuar e rezultateve të hedhura, të firmosura nga maturanti/kandidati, të vulosur dhe të firmosur nga drejtori i shkollës dhe kopja tjetër ruhet në arkivin e shkollës.

n) Plotëson në periudhën e përcaktuar nga QSHA-ja, bazën e të dhënave për maturantët/kandidatët për vitin e fundit të shkollës së mesme.

o) Pajis çdo maturant/kandidat me një kopje të printuar të rezultateve të hedhura të të gjitha viteve të shkollës së mesme, e vulosur dhe e firmosur nga maturanti/kandidati dhe drejtori i shkollës, ndërsa një kopje tjetër ruhet në arkivin e shkollës.

p) Përfundon procesin e verifikimit dhe konfirmimit të rezultateve në sistem në periudhën e përcaktuar nga QSHA-ja.

Neni 9

Detyrat e ASCAP-së, DPAP-së, AKAFPK-së dhe DRAP-së

1. ASCAP-ja harton programet lëndore orientuese për provimet e Maturës Shtetërore, të cilat publikohen në faqet zyrtare të ASCAP, QSHA dhe MASR.

Faqe | 2078

2. AKAFPK-ja harton programet orientuese të provimit të Teorisë Profesionale të Integruar, për çdo drejtim/profil profesional, të provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale. Programet orientuese publikohen në faqet zyrtare të AKAFPK-së dhe të QSHA-së.

3. DPAP-ja ka për detyrë:

a) të koordinojë me MASR, DRAP dhe ZVAP të gjithë procesin e MSH-së;

b) të koordinojë me DRAP dhe të sigurojë cilësinë në trajnimin e PAP-së, AP-së, PK-së dhe AS.

4. DRAP ka për detyrë:

a) të mbështesë zhvillimin e provimeve të MSH-së;

b) të monitorojë ZVA-të për zbatimin e akteve ligjore për MSH-në;

c) të monitorojë dhe të sigurojë gjendjen e infrastrukturës të qendrave të provimit.

KREU III

PROCEDURAT E PROVIMEVE TË MATURËS

Neni 10

Forma e provimeve dhe kriteri i kalueshmërisë

1. Provimet e Maturës Shtetërore dhe provimet e Maturës Shtetërore Profesionale zhvillohen vetëm me shkrim.

2. Struktura, datat dhe kohëzgjatja e provimeve të Maturës caktohen me udhëzim të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Struktura, datat dhe kohëzgjatja e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale, përcaktohen me udhëzim të përbashkët Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

4. Maturanti/kandidati konsiderohet mbetës në provim nëse ka marrë më pak se 25% të pikëve të testit.

Neni 11

E drejta për dhënien e provimeve të Maturës

1. Provimet e Maturës i jep maturanti/kandidati që ka përfunduar me sukses vitin e fundit të shkollës së mesme dhe shkollës së mesme profesionale dhe ka plotësuar formularin A1/A1Z.

2. Kandidatët, që në Maturat Shtetërore 2012–2019, rezultojnë kalues në një prej provimeve me



zgjedhje, dhe nuk janë pajisur me diplomën e maturës/certifikatën, atëherë të pajisen me to.

3. Kandidatët, të cilët kanë marrë dëftesë pjekurie para vitit 2011 dhe dëshirojnë të aplikojnë për studime në institucionet e arsimit të lartë, t'u njihen provimet e detyruara dhe me zgjedhje ose provimet e njëvlershme me to të njehsuara nga ZVA-ja. Këta kandidatë, në rastet kur nuk kanë dhënë provime me zgjedhje ose i kanë dhënë dhe nuk kanë rezultuar kalues, kanë të drejtë të japin një provim me zgjedhje kur e kanë të nevojshme për plotësimin e kriterëve të pranimit të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

4. Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2014, por nuk janë pajisur me dëftesë pjekurie/diplomë, nuk e japin gjuhën e huaj si provim të detyruar. Pasi kanë fituar provimet e Maturës, marrin diplomë dhe certifikatë të Maturës Shtetërore.

5. Çdo maturant që fiton provimet e detyruara dhe provimin me zgjedhje, pajiset me diplomë.

6. Çdo maturant i arsimit të mesëm të lartë profesional, fiton provimet e detyruara, pajiset me diplomë të Maturës Shtetërore Profesionale.

7. Diploma e Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale lëshohet vetëm një herë.

8. Maturanti/kandidati, nëse nuk rezulton kalues në sesionin e parë të Maturës, në sesionet e ardhshme jep vetëm provimin/et e detyruara dhe me zgjedhje, në të cilat ka mbetur.

Neni 12

Përgatitja e testeve të Maturës

1. QSHA-ja miraton ngritjen e grupeve lëndore për hartimin e fondit të pyetjeve sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi dhe rregullores së brendshme të institucionit. Anëtarët e grupeve lëndore në kontratën që nënshkruajnë me QSHA-në merr përsipër të ruajë sekretin e hartimit të fondit të testeve dhe të mos jetë në konflikt interesi, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi. Fondi i pyetjeve është jo më i vogël se njëzetfishi i pyetjeve që do të përmbajë testi përkatës.

2. QSHA-ja miraton ngritjen e grupeve të punës, për hartimin e testeve të Maturës Shtetërore Profesionale, sipas drejtimeve/profileve të miratuara me udhëzim të posaçëm.

3. Përzgjedhja e testeve përfundimtare të provimeve të Maturës do të bëhet përmes teknologjisë digjitale

KREU IV

APLIKIMI PËR PROVIMET E MATURËS

Neni 13

Përgatitja dhe publikimi i formularëve A1 dhe A1Z

1. Në faqen zyrtare të QSHA-së shpallen:

a) Formularët A1 dhe A1Z.

b) Udhëzuesi i plotësimit online të formularit A1/A1Z nga maturanti/kandidati në portalin qeveritar “e-albania”, si dhe në vijim në portalin “Matura Shtetërore”.

c) Udhëzuesi i plotësimit online të bazës së të dhënave nga KSHMSH-ja në portalin “Matura Shtetërore”.

d) Udhëzuesi i plotësimit të bazës së të dhënave nga KSHMSH-ja në portalin “Maturanti”.

2. Maturanti/kandidati bën aplikimin online, fillimisht në portalin qeveritar “e-albania”, më pas, në portalin “Matura Shtetërore”, në periudhën e përcaktuar nga QSHA-ja, sipas një plani kalendar të publikuar në faqen e internetit të QSHA-së. Aplikimi në portalin “Matura Shtetërore”, bëhet edhe sipas afateve të vendosura nga QSHA-ja.

3. KSHMSH-ja, deri në datën e përcaktuar nga QSHA-ja afishon në shkollë, një kopje të bazës së të dhënave, të shkarkuar nga portali i Maturës Shtetërore dhe pret vërejtjet e maturantëve/kandidatëve për korrigjime të mundshme në bazën e të dhënave të regjistruara në portalin “Matura Shtetërore”. Brenda datës së përcaktuar nga QSHA-ja, KSHMSH-ja bën verifikimet dhe korrigjimet përkatëse në sistem.

4. Çdo maturant/kandidat do të plotësojë/firmosë në KSHMSH formularin e deklaramit të saktësisë së të dhënave të tij në portalin “Matura Shtetërore” dhe ky formular ruhet nga KSHMSH-ja deri në përfundimin e vitit shkollor përkatës.

Neni 14

Plotësimi i formularëve A1 dhe A1Z

1. Plotësimi i formularit A1 nga maturantët e këtij viti shkollor bëhet në shkollat ku ata kryejnë arsimin e mesëm të lartë dhe arsimin e mesëm të lartë profesional.



2. Plotësimi i formularit A1Z, nga maturantët e viteve të mëparshme (kandidatët), bëhet në shkollat ku ata kanë kryer arsimin e mesëm të lartë. Në rastin kur shkolla e mesme është mbyllur, KMSH-ja cakton një shkollë të vetme, në të cilën kandidatët bëjnë plotësimin e formularit A1Z. Kandidatët bëjnë plotësimin e formularit A1Z në shkollën e përcaktuar nga KMSH-ja, duke paraqitur në KMSH e ZVA-së dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën me shkrim për dhënien e provimeve të Maturës Shtetërore dhe/ose për të aplikuar në IAL.

b) Kopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë/vërtetimin me notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme me fotografi/certifikatën e Maturës me notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme, lëshuar nga drejtori i shkollës, sipas regjistrit të amzës apo dokumentit të lëshuar nga Arkivi i Shtetit.

3. Plotësimi i formularit A1Z nga kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, bëhet në shkollën e përcaktuar nga KMSH-ja në ZVA.

4. KMSH-ja e ZVA-së i dërgon zyrtarisht KSHMSH-së dokumentet e dorëzuara nga kandidati si dhe vërtetimin e notave të provimeve të Maturës Shtetërore. Ky vërtetim i bashkëngjitet formularit të aplikimit A1Z dhe ruhet në shkollë.

5. Kandidati i para vitit shkollor 2011, jep provime të Maturës sipas kritereve të përcaktuara në udhëzimin e MASR-së, “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore”.

6. Për shkollat profesionale dhe shkollat e mesme të orientuara, në rastet kur kandidati ka fituar dëftesën e pjekurisë, si provime të detyruara njihen:

a) Letërsia dhe matematika, nëse janë dhënë dhe janë fituar.

b) Një ose dy nga provimet, në mungesë të letërsisë dhe të matematikës, sipas planit mësimor të shkollës së tyre. KMSH në ZVA përcakton provimet, rezultatet e të cilave do të mbarten në sistem në vend të letërsisë dhe matematikës.

Neni 15

E drejta për dhënien e provimeve të Maturës për kandidatët

1. Kandidatët nuk lejohen të rijapin provimet e Maturës Shtetërore dhe provimet e Maturës

Shtetërore Profesionale, të detyruara dhe me zgjedhje, nëse në maturat e viteve të mëparshme, rezultatet janë jo më të ulëta se 4.50.

2. Në maturat para vitit kur po aplikohet Matura Shtetërore, në rastet kur kandidati ka dhënë më shumë se një herë një lëndë/lëndët në provimet me zgjedhje, i njihet vetëm rezultati i vitit të fundit.

KREU V

QENDRAT DHE MJEDISËT E ZHVILLIMIT TË PROVIMEVE TË MATURËS

Neni 16

Kriteret për qendrat dhe mjediset e provimit

1. Mjediset ku do të zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore të jenë të ajrosura dhe të ndriçuara.

2. Drejtori i shkollës, drejtori dhe punonjësit e ZVA përkatëse e kanë të ndaluar të qëndrojnë në mjediset e provimit të MSH-së gjatë kohës së zhvillimit të provimeve.

3. Qendrat të jenë të mjaftueshme për të paktën 150 maturantë/kandidatë, përveç rasteve të veçanta të cilat bëhen me miratim nga KOMSH-ja.

4. Largësia ndërmjet çdo maturanti/kandidati të jetë jo më pak se 120 cm, në të katër drejtimet, si majtas-djathtas, ashtu dhe para-prapa.

5. Maturantët/kandidatët të ulen me fytyrë në të njëjtën drejtim.

6. Sipërfaqja që maturanti/kandidati ka në dispozicion për të shkruar të jetë të paktën 40 cm x 60 cm.

7. Në ditën e provimit, në qendrat ku zhvillohet provimi, nuk parashikohen veprimtari të tjera.

8. Në mjediset ku zhvillohet provimi, nuk duhet të ketë tabela ose materiale të tjera që kanë lidhje me lëndën që jepet provim.

9. Ndryshimi i qendrave të provimit bëhet vetëm me miratim të KOMSH.



KREU VI
PROCEDURAT E SHPËRNDARJES DHE
GRUMBULLIMIT
TË MATERIALEVE TË PROVIMEVE TË
MATURËS

Neni 17

Transporti i materialeve të provimeve

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Posta Shqiptare organizojnë transportin e materialeve të provimeve, ruajtjen e mjediseve në shkolla, në QSHA dhe në qendrat e vlerësimit të testeve. Format e bashkëpunimit mes tyre përcaktohen në urdhrin/marrëveshjen e përbashkët të dy ministrave përgjegjës dhe të drejtorit të Postës Shqiptare.

Neni 18

Shpërndarja dhe grumbullimi i materialeve të provimeve

1. Shpërndarja dhe grumbullimi i materialeve të provimeve bëhet me procesverbal. Materialet e provimit tërhiqen në QSHA nga personi i autorizuar i Postës Shqiptare në prani të përfaqësuesit të autorizuar të MASR-së dhe të shërbimeve të Policisë së Shtetit, sipas një grafiku të përcaktuar nga QSHA-ja.

2. Personat e autorizuar, sipas këtij neni, mbajnë përgjegjësi për ruajtjen e sekretit dhe sigurimin e materialeve të provimit.

3. Materialet e çdo provimi duhet të arrijnë në KMSH të ZVA-së jo më vonë se ora 08:00 e ditës kur do të zhvillohet provimi.

4. Dorëzimi i materialeve në KMSH të ZVA-së bëhet me procesverbal, në të cilin evidentohet përmbajtja e elementeve të sigurisë (vulat). Procesverbali nënshkruhet nga përfaqësuesit e autorizuar të Postës Shqiptare dhe të MASR-së, si dhe nga kryetari i KMSH-së të ZVA-së.

5. Në ditën që do të zhvillohet provimi, materialet tërhiqen me procesverbal në KMSH e ZVA-së nga PAP, në prani të përfaqësuesit të MASR-së.

6. Pas çdo provimi, PAP-ja dorëzon me procesverbal materialet e provimit te kryetari i KMSH-së të ZVA-së. Përfaqësuesi i MASR-së, përfaqësuesi i Postës dhe punonjësi i Policisë së

Shtetit të cilët shoqërojnë materialet e provimit dhe i dorëzojnë ato në QSHA.

7. Përfaqësuesi i KMSH-së të ZVA-së dhe të PAP-së mbajnë përgjegjësi sipas dispozitave ligjore në fuqi për ruajtjen e sekretit dhe sigurimin e materialeve të provimit.

Neni 19

Administrimi i materialeve të provimit në qendrën e provimit

1. PAP-ja është përgjegjës për materialet e provimit nga momenti i marrjes në dorëzim me procesverbal, nga kryetari i KMSH-së të ZVA-së deri në dorëzimin e tyre pas përfundimit të provimit.

2. Pas shpërndarjes së materialeve të provimit, PAP-ja dhe AP-ja mbajnë procesverbal për testet që nuk përdoren dhe i mbyllin ato (bashkë me procesverbalin) në një zarf, i cili vendoset në një vend të sigurt brenda mjediseve të provimit, deri në përfundim të tij. Procesverbali plotësohet në dy kopje, njëra futet në kuti dhe tjetra dorëzohet nga PAP-ja te përfaqësuesi i KMSH-së të ZVA-së në momentin e dorëzimit të kutisë. Ky zarf përbën objekt verifikimi nga QSHA-ja dhe KOMSH-ja.

3. Pas përfundimit të provimit, AP-ja i dorëzon me procesverbal PAP-së testet e plotësuara nga çdo maturant/kandidat, të ndara sipas llojit të testit.

4. Pas përfundimit të provimit, AP-ja i dorëzon me procesverbal PAP-së listat emërore të firmosura nga çdo maturant/kandidat pas përfundimit dhe dorëzimit të testit, për mjedisin që ai ka administruar.

5. Testet e plotësuara, ato të papërdorura, si dhe materialet e tjera të provimit, PAP-ja i mbyll në kuti në prani të përfaqësuesit të MASR-së dhe AP-së.

6. Kutia e mbyllur vulolet nga drejtori i shkollës i cili paraqitet në qendrën e provimit vetëm pas përfundimit të provimit në atë qendër. Kur provimi zhvillohet në mjedise të tjera, jo në shkolla, atëherë kutia vulolet nga drejtori i shkollës së përzgjedhur nga KMSH-ja në ZVA.

7. Përfaqësuesi i KMSH-së dhe PAP-së dorëzojnë me procesverbal në KMSH të ZVA-së, kutinë me materialet e provimit.



KREU VII PROCEDURAT E CAKTIMIT TË ADMINISTRATORËVE TË PROVIMIT

Neni 20

Numri i administratorëve të provimit dhe caktimi i tyre në qendrat/mjediset e provimit

1. Për çdo 15-20 maturantë/kandidatë, caktohet një administrator provimi.

2. KMSH-ja në ZVA, në bashkëpunim me KSHMSH-në, përcakton numrin e nevojshëm të AP-së, PAP, PK, AS për mjediset e çdo provimi.

3. KMSH-ja në ZVA harton, një muaj përpara provimit të parë të maturës, listën emërore të PAP-së, AP, AS dhe PK për çdo provim. Kjo listë duhet të përmbajë dyfishin e personave të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

4. PAP-ja, AP-ja, AS-ja dhe PK-ja pajisen nga KMSH-ja në ZVA me manualin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre në proces, si dhe nënshkruajnë deklaratat e përgjegjshmërisë.

5. KMSH-ja e ZVA-së, në prani të përfaqësuesit të MASR-së, hedh shortin elektronik për administrimin e qendrave dhe mjediseve ku do të zhvillohen provimet. Rezultati i shortit pasqyrohet në procesverbal, që hartohet nga KMSH-ja.

KREU VIII ADMINISTRIMI I PROVIMIT

Neni 21

Detyrat e përgjegjësit të administrimit të provimit

1. Përgjegjësi i administrimit të provimit të jetë punonjës i njësive vendore arsimore apo person i autorizuar nga drejtori i njësisë vendore arsimore.

2. Përgjegjësi i administrimit të provimit, ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Të jetë i trajnuar dhe të mos jetë mësues i shkollës së maturantit/kandidatit dhe i lëndës së provimit.

b) Tërheq në KMSH të ZVA-së materialet e provimit.

c) Ndalohet të mbajë celular gjatë zhvillimit të provimit.

d) Kryen identifikimin e AP-së, AS-së dhe të PK-së sipas listës së ardhur nga ZVA-ja.

e) Merr masa që të thërrasë ndihmën e shpejtë në rast nevojë dhe i shoqëron maturantët në prani të përfaqësuesit të MASR-së.

f) Udhëzon dhe cakton me short, në prani të përfaqësuesit të MASR-së, administratorët e provimit për çdo mjedis.

g) Nuk lejon prezencën e drejtuesve të shkollave dhe punonjësve të ZVA-së gjatë zhvillimit të provimit.

h) Fillon identifikimin e maturantëve/kandidatëve 1 orë e 30 minuta para provimit, sipas listës emërore të dërguar nga QSHA-ja.

i) Kryen kontrollin fizik të çdo maturanti/kandidati, në bashkëpunim me përgjegjësit e kateve, të cilin e dokumenton me një procesverbal të nënshkruar nga ata. Procesverbali futet në kutinë e materialeve të provimit.

j) U shpërndan me procesverbal AP-së materialet e provimit.

k) Nuk lejon hyrjen e personave të paautorizuar në qendrën e provimit.

l) Raporton në KMSH e ZVA për çdo rast parregullsie gjatë zhvillimit të provimit.

m) Dokumenton çdo parregullsi dhe masë që merr, sipas procesverbalit të dërguar nga QSHA-ja, të cilin e fut në kutinë e materialeve të provimit.

n) Plotëson me saktësi dhe përgjegjësi formularin e zhvillimit të provimit.

o) Paketon pas përfundimit të provimit, testet e përdorura dhe materialet e tjera të provimit, sipas udhëzuesit të dërguar nga QSHA-ja.

p) Shoqëron pas përfundimit të provimit, materialet e provimit dhe i dorëzon ato në KMSH të ZVA-së.

q) Nuk publikon në asnjë mënyrë apo formë testin e Maturës Shtetërore gjatë procesit të administrimit.

r) Të ketë një veshje dhe paraqitje serioze që t'i përgjigjet vendit dhe natyrës së punës.

Neni 22

Detyrat e administratorit të provimit

1. Administrator provimi të jetë mësuesit dhe praktikantët e mësuesisë.

2. Mësuesit nuk mund të caktohen administratorë të provimit në institucionin arsimor ku janë të punësuar dhe as në provimet e fushës ku janë diplomuar.



3. Praktikantët nuk mund të caktohen si administratorë në institucionin arsimor ku kanë kryer praktikën profesionale dhe në provimet e fushës ku janë të diplomuar.

4. Administratori i provimit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Ndalohet të mbajë celular gjatë zhvillimit të provimit.

b) Identifikon në mjedisin e provimit çdo maturan/kandidat dhe i drejton ata në vendin e caktuar, sipas listës së dërguar nga QSHA-ja.

c) Lë bosh vendin e caktuar për maturan/kandidatin që mungon.

d) Njeh maturanët/kandidatët me të drejtat dhe sanksionet e parashikuara në këtë rregullore.

e) Nuk lejon ndërrimin e vendeve të maturanëve/kandidatëve.

f) Dorëzon te PAP-ja, bashkë me testet, edhe dokumentin që vërteton që nxënësi është me aftësi të kufizuar në rastet kur në mjedis ka nxënës të tillë.

g) Shpërndan dhe grumbullon për çdo maturan/kandidat testet sipas llojit të përcaktuar në listën e QSHA-së, me listë prezencë të nënshkruar nga maturan/kandidati për tërheqjen dhe për dorëzimin e testit/testeve dhe mban përgjegjësi për këtë proces.

h) Njofton PAP-në dhe merr masat për ndërrimin e testit të maturanit/kandidatit, të cilit i është dhënë test i lëndës që nuk e ka zgjedhur apo që nuk përshtatet me testin e shkollës, sipas indeksit të shënuar në formularin A1/A1Z të tij.

i) Nëse një maturan/kandidat gjatë zhvillimit të provimit me zgjedhje nuk i përputhet testi me lëndën që ai ka zgjedhur, ai do të bëjë provimin për lëndën që ai zgjedh kundrejt një procesverbali të mbajtur nga PAP dhe AP, si dhe të nënshkruar nga vetë maturan.

j) Nuk lejon përdorimin e telefonit celular, radios ose çdo mjeti tjetër komunikimi, si dhe komunikimin e maturanëve/kandidatëve me njëri-tjetrin ose me persona jashtë mjedisit të provimit.

k) Nuk komunikon me maturan/kandidatin për përmbajtjen e testit.

l) Nuk lejon largimin e maturanit/kandidatit nga mjedisi i provimit pa përfunduar koha e përcaktuar në aktet ligjore dhe pa dorëzuar testin e provimit që ka zhvilluar.

m) Nuk lejon hyrjen e personave të paautorizuar në mjedisin e provimit ku ai është caktuar për ta administruar.

n) Njofton, dokumenton dhe raporton te PAP-ja çdo rast parregullsie.

o) Kontrollon testin e dorëzuar nga maturan/kandidati nëse ka dëmtime, si: palosje, grisje, zhubrosje etj.

p) Nuk largohet nga mjedisi i provimit dhe nuk kryen veprime të tjera që nuk lidhen me administrimin e provimit.

q) Respekton orarin e zhvillimit të provimit.

r) Të ketë një veshje dhe paraqitje serioze që t'i përgjigjet vendit dhe natyrës së punës.

s) Të mos publikojë në ndonjë mënyrë apo formë testin e Maturës Shtetërore gjatë procesit të administrimit.

Neni 23

Detyrat e administratorit të sekretimit

1. Për kryerjen e procesit të sekretimit, KMSH-ja cakton një AS për çdo 45 maturan/kandidatë. AS duhet të jenë të trajnuar nga QSHA dhe KMSH.

2. Administratori i sekretimit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Të jetë i trajnuar dhe të mos jetë mësues i shkollës së maturanit/kandidatit dhe i lëndës së provimit.

b) Identifikon çdo maturan/kandidat dhe sekreton testet me barkodet përkatëse, mbështetur në listën e dërguar nga QSHA-ja.

c) Siguron që maturan/kandidati nënshkruan përmbajtjen e testit të tij në listë.

d) Ndalohet të mbajë celular gjatë zhvillimit të provimit.

e) Sekreton testet pasi ka përfunduar shpërndarja e tyre.

f) Dorëzon te PAP-ja barkodet e papërdorura, pas përfundimit të procesit të sekretimit.

g) Qëndron në një mjedis të caktuar nga PAP, deri në fund të procesit të provimit, duke kryer detyra që mund t'i ngarkojë ai.

h) Të ketë një veshje dhe paraqitje serioze që t'i përgjigjet vendit dhe natyrës së punës.

Neni 24

Detyrat e përgjegjësit të katit

1. Për kryerjen e procesit të administrimit për qendra me më shumë se dy kate, KMSH-ja e ZVA-së cakton një përgjegjës kati.



2. Përgjegjësi i katit të jetë punonjës i njësisë vendore arsimore apo person i autorizuar nga drejtuesi i kësaj njësie. Përgjegjësi i katit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Ndihmon PAP-në, AP-në, AS-në, në administrimin e provimit.
- b) Të jetë i trajnuar dhe të mos jetë mësues i shkollës së maturantit/kandidatit dhe i lëndës së provimit.
- c) Ndalohet të mbajë celular gjatë zhvillimit të provimit.
- d) Nuk lejon hyrjen e personave të paautorizuar në mjedisin e katit, ku ai është caktuar për ta administruar.
- e) Njofton, dokumenton dhe raporton te PAP-ja, AP-ja çdo rast parregullsie.
- f) Nuk largohet nga mjedisi i provimit gjatë provimit dhe nuk kryen veprime të tjera që nuk lidhen me administrimin e provimit.
- g) Respekton orarin e zhvillimit të provimit.
- h) Të ketë një veshje dhe paraqitje serioze që t'i përgjigjet vendit dhe natyrës së punës.
- i) Të mos publikojë në ndonjë mënyrë apo formë testin e Maturës Shtetërore gjatë procesit të administrimit.

Neni 25

Detyrat e përfaqësuesit të MASR-së

1. Përfaqësuesi i MASR në qendrën e provimit monitoron që i gjithë procesi të zhvillohet në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje. Në ato qendra, ku janë vërejtur shkelje apo parregullsi, ka detyrim të raportojë me shkrim në KOMSH.

2. Si përfaqësues të ministrisë në provimet e MSH do të jenë punonjës të MASR dhe institucioneve të varësisë, si dhe oficerët e sigurisë.

3. Përfaqësuesi i MASR-së, mbështet dhe këshillon të gjithë personat që administrojnë provimet e Maturës Shtetërore.

4. Përfaqësuesi i MASR-së trajnohet nga KOMSH-ja.

5. Ai raporton në KOMSH brenda ditës, për procesin e provimit të Maturës që ai ka monitoruar.

Neni 26

Detyrat dhe të drejtat e maturantit/kandidatit

1. Maturanti/kandidati paraqitet në qendrën e provimit 1 orë e 30 minuta përpara fillimit të provimit dhe duhet të ketë dokumentin e identifikimit si dhe mjetet e nevojshme: stilolaps, vizore, kompas, makinë llogaritëse të thjeshtë.

2. Maturanti/kandidati pasi merr testin nga AP-ja, kontrollon gjendjen fizike të testit (është i palexueshëm, mungon ndonjë faqe etj.), si dhe nëse është lloji i testit që ka kërkuar në formularin A1/A1Z. Nëse vërehen parregullsi kërkon test tjetër nga AP-ja, duke plotësuar një deklaratë për marrjen e testit.

3. Maturanti/kandidati plotëson testin me stilolaps me një ngjyrë (të zezë ose blu). Në pyetjet me alternativa, maturanti/kandidati rrethon vetëm shkronjën përbri përgjigjes së saktë. Nëse maturanti/kandidati rrethon më shumë se një alternativë, ose nuk rrethon asnjë alternativë, vlerësohet me 0 pikë.

4. Maturantët e seksioneve dygjuhëshe shkollore vendosen nga QSHA-ja në një mjedis, për shkak të monitorimit nga përfaqësitë përkatëse dhe në zbatim të marrëveshjeve dypalëshe.

5. Maturantëve/kandidatëve me aftësi të kufizuar, të përkohshme ose të përhershme, me kërkesën e prindit, u krijohen kushte të përshtatshme për zhvillimin e provimit. Për ata që nuk mund të lexojnë apo të shkruajnë, PAP-ja autorizon një prej AP-së, jo të profilin, për plotësimin e testit sipas përgjigjeve të dhëna me gojë nga maturanti/kandidati.

6. Maturantëve/kandidatëve të paraburgosur u sigurohen kushtet për zhvillimin normal të provimeve, në mjedise të posaçme nën mbikëqyrjen e përfaqësuesve të autorizuar të policisë, pa uniformë dhe pa armë.

7. Maturantët/kandidatët, kur e dorëzojnë testin, nënshkruajnë për dorëzimin e tij në listën që disponon AP-ja.

8. Maturantët/kandidatët që dorëzojnë testin e provimit përpara kohës së përcaktuar, nuk mund të dalin nga qendra e provimit para kohës së përfundimit të provimit. Ata grumbullohen brenda qendrës së provimit, në një mjedis të përcaktuar më parë.



9. Kur maturanti/kandidati vëren ndonjë shkelje të rregullores së provimit, ai ka të drejtë të informojë AP-në, PAP-në dhe përfaqësuesin e MASR-së.

10. Maturanti/kandidati ka të drejtë të kërkojë fotokopjen e testit të tij pas përfundimit të të gjitha provimeve.

11. Nuk ka rivlerësim të testit.

12. Maturanti/kandidati, i cili paraqitet në qendrën e provimit dhe/ose konstatohet gjatë provimit me celular përjashtohet nga ai provim dhe ka të drejtë ta japë atë në sesionin pasardhës.

Neni 27

Përjashtimi dhe mosnjohja e rezultatit të provimit

1. Maturanti/kandidati përjashtohet nga provimi, kur:

- a) Paraqitet në qendrën e provimit dhe/ose konstatohen gjatë provimit me celular
- b) Ndryshon vendin që i është caktuar.
- c) Merr, jep informacion apo kopje ose komunikon me maturantë/kandidatë të tjerë.
- d) Bën komente për përmbajtjen ose zgjidhjen e testit.
- e) Refuzon kontrollin nga ana e administratorëve gjatë hyrjes në qendrën e provimit.

2. Maturantit/kandidatit nuk i njihet rezultati:

- a) Nëse përdor laps, stilolapsa me ngjyra jo si ato të përcaktuara në nenin 26 të kësaj rregulloreje, ose përdor më shumë se një ngjyrë në plotësimin e testit.
- b) Nëse ka dëmtuar testin (e ka palosur, e ka zhubrosur, e ka grisur, i ka vendosur shenja të dallueshme dhe të veçanta), të evidentuar në procesverbal.
- c) Nëse vërtetohet kopja, e pjesshme ose e plotë, gjatë procesit të vlerësimit dhe konfirmohet nga KOPOTED-ja.
- d) Nëse është marrë masa e përjashtimit nga provimi.

KREU IX

PROCEDURA E VLERËSIMIT TË TESTEVE

Neni 28

1. Vlerësimi i përgjigjeve të maturantit/kandidatit bëhet me pikë, të cilat konvertohen në notë të shkallëzuar.

2. ZVA-ja vë në dispozicion të QSHA-së dhe të MASR-së, brenda muajit mars, listat e të gjithë mësuesve të shkollave të mesme për lëndët e provimeve të Maturës, sipas modelit të dërguar nga QSHA-ja.

3. Vlerësuesi i testeve të Maturës duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) të ketë arsimin universitar përkatës;
- b) të ketë jo më pak se 5 vjet përvojë pune në mësimdhënie në shkollën e mesme në lëndën përkatëse (preferohen mësuesit me mbi 10 vjet përvojë pune);
- c) të jetë treguar i saktë dhe i përpiktë në vlerësimet e mëparshme të provimeve të Maturës;
- d) të jetë i vlerësuar për rezultate të larta në mësimdhënie;
- e) të jetë i vlerësuar me të paktën “Mirë” dhe “Shumë mirë” në kualifikimin e fundit të mësuesve;
- f) të jetë i certifikuar si vlerësues;
- g) të mos ketë konflikt interesi.

4. Përzgjedhja e vlerësuesve të testeve kryhet çdo vit. Numri i tyre është në varësi të numrit të testeve që vlerësojnë dhe kohës së shpalljes së rezultateve të vlerësimit.

5. Para fillimit të procesit të vlerësimit të testeve, grupi i hartimit të testeve i QSHA-së orienton vlerësuesit e testeve në përputhje me kërkesat e testit dhe sipas skemës përkatëse të vlerësimit.

6. Vlerësimi i testeve realizohet në qendra vlerësimi me mjedise të përshtatshme dhe të sigurta, të përzgjedhura nga QSHA-ja.

7. Rezultatet e provimeve të Maturës shpallen jo më vonë se data 30 qershor.

Neni 29

Teste të parregullta dhe të dyshuara për kopje

1. QSHA-ja ngre komisione të posaçme (KOPOTED) që shqyrtojnë të gjitha testet që raportohen nga vlerësuesit e testeve si të dyshimta për kopjim dhe testet me parregullsi.



2. Vlerësuesit e testeve i dorëzojnë përgjegjësit përkatës të vlerësimit, testet me parregullsi apo që dyshohen për kopje. Përgjegjësi i vlerësimit, nga ana e tij, ia përcjell ato KOPOTED-së, duke i shoqëruar me një përshkrim të detajuar mbi parregullsitë dhe pyetjet që dyshohen për kopje.

3. KOPOTED-ja, për parregullsitë që konstaton informon me shkrim KOMSH-në.

KREU X KLASIFIKIMI I MATERIALEVE DHE RUAJTJA E TYRE

Neni 30

Materiale të rëndësishë së veçantë

1. Konsiderohen materiale të rëndësishë së veçantë:

a) Testet dhe skemat e vlerësimit të tyre, deri para shpalljes në faqen elektronike të MASR-së dhe të QSHA-së.

b) Testet e plotësuar nga çdo maturant/kandidat.

c) Formularët e Maturës.

d) Baza e të dhënave të Maturës.

e) Procesverbalet e AP-së, PAP-së, përgjegjësve të vlerësimit dhe vlerësuesve të testeve.

2) Personat fizikë e juridikë, të cilët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me materialet e konsideruara të një rëndësie të veçantë, sipas pikës 1, të këtij neni, veprojnë në përputhje me këtë rregullore. Në rast shkeljeje, ndaj tyre zbatohen dispozitat e Kodit Penal dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 31

Siguria, kodifikimi dhe ruajtja e materialeve të provimit

1. Për ruajtjen dhe sigurimin e dokumenteve dhe materialeve të provimit zbatohen këto rregulla:

a) Nënshkruhet kontratë individuale me çdo person që angazhohet në hartimin e testeve përfundimtare.

b) Ruhët në kompjuter, nga specialistët lëndorë i gjithë dokumentacioni i provimeve, duke përdorur elemente sigurie si: fjalëkalime të shumëfishta, mungesë komunikimi elektronik dhe në rrjet.

c) Paketohen me elemente sigurie materialet e provimit. Kutitë me materialet e provimeve vulosen dhe sekretohen nga QSHA-ja.

d) Ruhen dhe administrohen në QSHA të dhënat e provimeve të Maturës. Çdo dokument provimi dhe aplikimi i maturantit/kandidatit ruhet si dokument sekret në arkivin e QSHA, për 6 muaj.

2. Në mjediset e QSHA-së, përgjatë kohës së përgatitjes dhe shpërndarjes së testeve, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) Nuk lejohet hyrja e personave të paautorizuar në mjediset e QSHA dhe në ato të vlerësimit të testeve gjatë procesit të provimeve.

b) Ndalohet mbajtja e celularëve, mjeteve të tjera të komunikimit dhe gjithçka tjetër që cenon sigurinë e procesit në mjedisin teknik.

c) Lejohet të ketë një numër telefoni drejtori i QSHA-së, ose një person i autorizuar prej tij, për të komunikuar me ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ose me titullarin e ngarkuar prej tij.

d) Kryhet kontrolli fizik në mjedisin teknik të QSHA-së, gjatë hyrjes dhe daljes së personave të autorizuar. Me porosi të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, policia bën kontrolle të befasishme në mjediset e brendshme të QSHA-së, gjatë KOEPS-së.

KREU XI MASAT DISIPLINORE

Neni 32

Masat disiplinore

1. Për moszbatim të shkronjës “P” të nenit 8 të kësaj rregulloreje, ndaj drejtorit të shkollës, i cili është edhe në cilësinë e kryetarit të KSHMSH-së, merret masa “Vërejtje” nga titullari, masë e cila depozitohet në dosjen personale.

2. Për moszbatim të shkronjës “r” të pikës 2, të nenit 21, të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të administrimit të provimit, merret masa “Vërejtje”.

3. Për moszbatim të shkronjave “b”, “e”, “f”, “h”, “i”, “j”, “m”, “n”, “o” dhe “p”, të pikës 2, të nenit 21, të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të administrimit të provimit, merret masa “Paralajmërim për largim nga puna”. Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

4. Për moszbatim të shkronjave “c”, “d”, “k”, “g”, “l” dhe “q”, të pikës 2, të nenit 21, të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të administrimit të



provimit, merret masa “Largim nga puna”. Kjo masë pasqyrohet në librezën e punës së punonjësit.

5. Për moszbatim të shkronjave “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, “n”, “o”, “p”, “q” dhe “r”, të pikës 4, të nenit 22, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorit të provimit, merret masa “Vërejtje”. Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

6. Për moszbatim të shkronjave “a”, “b”, “j”, “k”, “m” dhe “s”, të pikës 4, të nenit 22, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të provimit, merret masa “Përfshim nga e drejta e dhënies së provimit për ushtrimin e profesionit të mësuesit” në sesionin e radhës nga data e dhënies së masës, ose masa “Largim nga puna” në rastin e mësuesve, masa të cilat pasqyrohen në librezën e punës.

7. Për moszbatim të shkronjës “h” të pikës 2, të nenit 23, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të sekretimit, merret masa “Vërejtje”.

8. Për moszbatim të shkronjave “b”, “c”, “e”, “f” dhe “g”, të pikës 2, të nenit 23, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të sekretimit, merret masa “Paralajmërim për largim nga puna”. Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

9. Për moszbatim të shkronjës “d”, të pikës 2, të nenit 23, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të sekretimit, merret masa “Largim nga puna”.

10. Për moszbatim të shkronjave “e”, “g” dhe “h”, të pikës 2, të nenit 24, të kësaj rregulloreje ndaj përgjegjësve të kateve, merret masa “Vërejtje”.

11. Për moszbatim të shkronjës “f”, të pikës 2, të nenit 24, të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të kateve, merret masa “Paralajmërim për largim nga puna”. Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

12. Për moszbatim të shkronjave “c”, “d” dhe “i”, të pikës 2, të nenit 24, të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të kateve, merret masa “Largim nga puna”. Kjo masë pasqyrohet në librezën e punës së punonjësit.

13. Për moszbatim të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 21, pikës 2 dhe 3, të nenit 22, shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 23 dhe shkronjës “b” të nenit 24, ndaj drejtorit të zyrës arsimore vendore merret masa “Largim nga detyra”, nga titullari përkatës. Kjo masë pasqyrohet në librezën e punës së punonjësit.

14. Për moszbatim të nenit 25, të kësaj rregulloreje, ndaj përfaqësuesve të MASR-së merren masat “Paralajmërim për largim nga detyra”, deri “Largim nga detyra”, sipas përcaktimeve të Kodit të Punës dhe masat e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi për shërbimin civil për përfaqësuesit nëpunës civil të MASR, masa të cilat depozitohen në dosjen personale.

15. Për pasaktësi në korigjim, ndaj vlerësuesve merren masat “Paralajmërim për largim nga detyra”, deri “Largim nga detyra”, si dhe përfshim nga e drejta për të qenë korigjues për 5 vjet, sipas përcaktimeve të Kodit të Punës, masë e cila depozitohet në dosjen personale.

16. Për publikim në të gjitha format të testeve të Maturës Shtetërore, nga hartuesit merret masa “Paralajmërim për largim nga detyra, deri në largim nga detyra”, si dhe përfshim nga e drejta për të qenë hartues për 5 vjet”, sipas përcaktimeve të Kodit të Punës, masë e cila depozitohet në dosjen personale.

17. Për publikim në të gjitha format të testeve të Maturës Shtetërore si materiale të një rëndësie të veçantë, nga çdo person i tretë deri në çastin e përfundimit të kohës së testimit, ndaj individit që i ka publikuar, do të kërkohet ndjekje penale nga organet përkatëse nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

18. Masat për shkeljet e parashikuara në këtë nen, si dhe masa të tjera të konstatuara gjatë procesit të Maturës Shtetërore të lidhura me çështje të etikës dhe integritetit merren nga titullari i institucionit. Komiteti i Maturës Shtetërore, pas shqyrtimit të procesverbaleve të dërguara nga QSHA-ja për shkeljet e konstatuara gjatë zhvillimit të provimeve të Maturës Shtetërore, i dërgon për kompetencë institucionit përkatës që aplikon masën sipas kuadrit ligjor në fuqi. Titullari i institucionit, ndjek procedurat sipas parashikimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 368 lekë